

Rrok Gjolak • Vjollca Osja

DRITARJA NGA SHOHIM BOTËN

LETËRSIA 6

Për klasën e gjashtë të shkollës fillore
LIBRI I MËSUESIT



Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore
PODGORICË, 2020

Rrok Gjolak Vjollca Osja

DRITARJA NGA SHOHIM BOTËN

LETËRSIA 6

PËR KLASËN E GJASHTË TË SHKOLLËS FILLORE

LIBRI I MËSUESIT

PROZOR ZA GLEDANJE SVIJETA

KNJIŽEVNOST 6

PRIRUČNIK ZA ŠESTI RAZRED OSNOVNE ŠKOLE

Botuesi: *Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore; Podgoricë*

Për botuesin: *Pavle Goranoviq*

Kryeredaktor: *Radulle Novoviq*

Redaktor përgjegjës: *Llazo Lekoviq*

Redaktor i librit: *Dimitrov Popoviq*

Recensues: *Dr. Marko Camaj
Prof. dr. Alfred Çapaliku
Aishe Resulbegoviq
Prof. dr. Gëzim Dibra
Prof.as.dr.Mithat Hoxha*

Dizajni dhe faqosja: *studio ZUNS*

Korrektor: *Dimitrov Popoviq*

Redaktore teknike: *Dajana Vukçeviq*

CIP – Каталогизација у публикацији
Национална библиотека Црне Горе, Цетиње

ISBN 978-86-303-2382-9
COBISS.CG-ID 17037060

Këshilli Kombëtar i Arsimit, me vendimin nr. 10903-119/20-3335/14 të datës 24. 07. 2020
e miratoi këtë komplet të Tekstit mësimor për përdorim në shkollat fillore.

Copyright © Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, Podgoricë, 2020

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE	4
KAPITULLI I	5
Gjergj Fishta: GJUHA SHQIPE.	6
Andon Z. Çajupit: FSHATI IM	8
Lasgush Poradeci: KROI I FSHATIT TONË.....	10
Aleksa Shantiq: RRINI KËTU ...!"	12
KAPITULLI II	14
Ibrahim Kadriu: LIBRI PËR PRINCIN E LUMTUR	15
Stripi : FUQIA E MUJIT	17
J.K. Rowling: HARRI POTER.....	19
Mimoza Ahmeti: GJYSHES.....	21
KAPITULLI III	22
Populli: PARAJA E FITUAR ME DJERSË.....	23
Asdreni: MËMA	25
Molier: BORGJEZ FISNIK	27
Ismail Kadare: POEZIA E PARË	29
PROVIM ME SHKRIM I	31
KAPITULLI IV	33
Fatos Arapi: BREDHI I VITIT TË RI	34
Viron Koka: BUBULINOJA ËSHTË KURESHTAR APO LLAFAZAN	35
Radovan Zogoviq: ALI BINAKU.....	36
Fadil Kraja: GJAKU I ARBËRIT	38
KAPITULLI V	40
Qerim Ujkani: VENDLINDJES	41
J.V. Gëte: LULJA E GJETUR	43
Azis Nesin: NUK ËSHTË E LEHTË TA HARROSH	45
Mitrush Kuteli: FUQIA E MUJIT	47
KAPITULLI VI	49
Mark Gurakuqi: BUKË E KRYPË E ZEMËR	50
Zef Serembe: MIQËSIA	52
Romen Rolan: KRISTOFI DHE PASANIKËT	54
Xhevahir Spahiu: DALLËNDYSHJA E FËMIJËRISË	56
PROVIM ME SHKRIM II	58
VLERËSIMI	60
LEXIMET JASHTË KLASE	61

PARATHËNIE

Libri i mësuesit i klasës së gjashtë mund të konsiderohet një material ndihmës për mësues-it/et që japin mësim në këtë nivel dhe që mbështetet në strategjitë e të mësuarit dhe kompetencat e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Gjatë hartimit të librit të mësuesit është pasur parasysh që t'i jepet një rëndësi e dorës së parë skemës së komunikimit letrar (artistik), si pjesë e suksesit të procesit mësimor.

autori	vepra	lexuesi	
		mësimdhënësi	nxënësi

Vendin kryesor në planin mësimor e ka zënë organizimi i orës së mësimit. Për çdo etapë kemi sugjeruar metodën dhe veprimtarinë që do të përdoret. Puna është konceptuar në zbërthimin e materialit që nxënësi ka në librin e nxënësit, duke i ofruar njohuritë që ka mësuesi, për ta ndihmuara në të zbërthimin e tekstit dhe në të kuptuarin aktiv dhe kreativ të tij. Për këtë arsye nxënësi është trajtuar si aktor veprues, i cili bashkëvepron në plotësimin e materialit bashkë me mësuesin. Etapa e parë, sidomos, i është lënë më shumë ndërveprimi të nxënësit, i cili teston njohuritë e tij dhe aktivizon fuqinë e të menduarit asociativ dhe të të shprehurit bukur.

Në të gjitha temat, është treguar kujdes që të trajtohen ushtrimet e librit të mësuesit, herë si punë orientuese e mësuesit me nxënësin e herë si punë e vetë nxënësit. Po kështu është treguar kujdes në sugjerimet për detyrat e shtëpisë, punët me shkrim dhe projektet, duke pasur parasysh që temat të ndihmojnë në zhvillimin e mëtejshëm të forcimit të dijeve dhe të punës së pavarur dhe krijuese të nxënësit.

KAPITULLI I

Gjergj Fishta

GJUHA SHQIPE

Planifikim mësimi

Lënda: Letërsi

Klasa: VI

Tema mësimore: Gjergj Fishta "Gjuha shqipe"

Lloji: poezi lirike

Rezultatet e të nxënimit të kompetencave sipas temës mësimore:

- Lexon me intonacionin e duhur këtë tekst poetik;
- Shpreh përjetimet e tij pas leximit të tekstit poetik;
- Shpjegon lidhjen e ritmit të poezisë me temën e saj;
- Formulon temën dhe evidenton motivet që mbart teksti poetik
- Përcakton kuptimet e para dhe të figurshme të fjalëve në tekst.

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: aktivizim i brain storm-it; nxitja e diskutimeve dhe e punës në grup.

Organizimi i orës së mësimi

Veprimtaria e mësues-it/es:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Etapa e parë:

Mësues-i/ja kërkon të dijë nëse nxënësit kanë mësuar në shkollë apo jashtë saj ndonjë poezi që i kushtohet gjuhës shqipe. Pastaj u kërkon nxënësve të thonë emrin e autorit dhe të recitojnë disa vargje nga ajo poezi. Mësues-i/ja shkruan dy strofa nga poezia "Gjuha shqipe" e Mjedës dhe veçon disa prej fjalëve apo shprehjeve kyçe nga vargjet e kësaj poezie:

Përmbi za qi lëshon bylbyli
Gjuha shqype m'shungullon;
Përmbi erë që nep zymbyli
Pa dalë zemrën ma ngushullon

Njikto gjuhë që jam tuj ndie
Janë të bukra me temel;
Po prap kjo si diell pa hije
Për mue t'anave ju del.

Mësues-i/ja bën lidhjen e temës së ditës me kontekstin e poezive që u recituan në klasë dhe vargjeve që shkroi në tabelë. Mësues-i/ja flet për rëndësinë e gjuhës amtare si një shenjë identiteti dhe u kërkon nxënësve të shprehin, se:

Çfarë është për ta gjuha amtare? Pse nuk duhet ta harrojmë atë?

Pse të tjerët na identifkojnë nga gjuha amtare që flasim?

Pse ndiejmë emocione kur flasim për të?

Cilat janë epitetet me të cilët do ta përcaktonin gjuhën amtare?

Etapa e dytë:

Mësues-i/ja shkruan në tabelë titullin e poezisë "Gjuha shqipe" dhe emrin e autorit. Pastaj u shpjegon nxënësve se kush është Gjergj Fishta, duke dhënë pak të dhëna për jetën dhe veprën e tij. Mësues-i/ja lexon me intonacionin e duhur poezinë, duke u ndalur dhe shqiptuar më me intonacion ato fjalë që mbartin peshën më të madhe emocionale.

Mësues-i/ja orienton nxënësit të lexojnë me radhë dhe në mënyrë shprehëse poezinë "Gjuha shqipe". Mësues-i/ja udhëzon nxënësit të nënvizojnë fjalë apo shprehje që u duken të veçanta dhe befasuese, po kështu edhe fjalët e panjohura për ta. Mësues-i/ja shpjegon fjalët e reja, si p.sh. gjama, zgjetare etj., dhe kërkon që së bashku me nxënësit të evidentojnë figurat letrare që ka teksti. Mësues-i/ja bën pyetje rreth përmbajtjes së tekstit, si p.sh. me çfarë krahasohet gjuha shqipe? Kë mallkon autori? Nga se na njohin të tjerët në botë? etj.

- U kërkon nxënësve t'u përgjigjen me pak fjalë pyetjes 1. dhe 2 të analizës letrare në librin e nxënësit.
- Jep udhëzime për pyetjet 3,4,5 në librin e nxënësit.
- Jep shpjegime në lidhje me nocionet *ritëm* dhe *rimë* dhe udhëzon nxënësit për pyetjet që lidhen me ritmin dhe rimën e vjershës. U kërkon nxënësve t'u përgjigjen pyetjeve 7,8,9, që janë në librin e nxënësit.
- U kërkon nxënësve të gjejnë krahasimet/që tregojnë ëmbëlsinë dhe bukurinë e gjuhës shqipe sipas pyetjes 11 në librin e nxënësit.

Detyrë shtëpie:

mësuesi-/ja u kërkon nxënësve të shkruajnë një vjershë të shkurtër për gjuhën shqipe, duke përdorur me kujdes figurat e krahasimit dhe epitetit. (detyra është e shënuar në librin e nxënësve)

Kompetenca e Vlerësimit:

Mësues-i/ja vlerëson aftësinë e nxënësve për të lexuar bukur e për të menduar në mënyrë kreative.

Vërejtjet e mësues-it/es

Andon Zako Çajupi

FSHATI IM

Planifikim mësimi

Lënda: Letërsi

Klasa: VI

Tema mësimore: Andon Zako Çajupi "Fshati im"

Lloji: poezi lirike

Rezultatet e të nxëniti të kompetencave sipas temës mësimore. Nxënësi/ja:

- mëson të njohë karakteristikat e poezisë së peizazhit dhe asaj sociale;
- eidenton temën dhe idetë që përcjell teksti poetik;
- eidenton figurat letrare dhe shpjegon lidhjet në mes tyre dhe përmbajtjes së poezisë lirike
- njih rimën si element organizues të vargut/strofës dhe formë tingëlluese në tekst

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: diskutimi në grup; nxitja e aftësisë së të shprehurit të mendimeve kritike; nxitja e të shprehurit nëpërmjet ilustrimit; nxitja e të shprehurit kreativ dhe e diskutimeve.

Organizimi i orës së mësimi

Veprimtaria e mësues-it/es:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Etapa e parë:

Mësues-i/ja u flet nxënësve për karakteristikat e poezisë së peizazhit dhe asaj me motive sociale. E ilustron mendimin e tij/saj me poezi që nxënësit kanë mësuar gjatë viteve paraardhëse.

Etapa e dytë:

Mësues-i/ja shkruan në tabelë titullin e poezisë "Fshati im" dhe emrin e autorit. Pastaj u shpjegon nxënësve kush është Andon Zako Çajupi dhe çfarë ka shkruar ai.

Lexon ngadalë dhe me intonacionin e duhur vargjet e poezisë duke u ndalur pas secilës strofë. Diskuton me nxënësit për emocionet që ju ngjalli ky tekst dhe nxit interpretimin individual të tekstit, duke u mbështetur në kapacitetin dhe kulturën e leximit të secilit nxënës.

Mësues-i/ja përdor strategjinë e leximit me zë dhe me radhë të tekstit nga nxënësit.

Orienton nxënësit në një lexim aktiv të tekstit: kërkon që nxënësit të shënojnë fjalët dhe shprehjet që mbartin peshën kryesore të kuptimit të poezisë; kërkon që nxënësit të shënojnë strofën/strofat që shprehin më mirë temën e kësaj poezie.

Nxit diskutime për motivet dhe përmbajtjen e vjershës.

Tërheq vëmendjen për muzikalitetin që ka poezia dhe shpjegon elementët që e realizojnë atë: ritmi dhe rima.

Organizon punën në grupe dhe kërkon që secili grup të shkruajë nga një punim/ ese të shkurtër me temën e poezisë .

Mësues-i/ja kërkon nga nxënësit të eidentojnë vargjet ku tregohet qëndrimi i autorit për figurën e burrit dhe të gruas në tekst.

a)

Qëndrimi i autorit
për figurën e
burrit

b)

Qëndrimi i autorit
për figurën e
gruas

Kërkon nga nxënësit të eidentojnë fjalët kyç të poezisë dhe të shpjegojnë funksionin e tyre në poezi.

Orienton nxënësit në interpretimin që ata i bëjnë detyrave nr. 1. 3. 6.7.9 11 në librin e nxënësit dhe i lë të lirë në formulimin e mendimeve të tyre, duke nxitur mendimet origjinale dhe kreative.

Diskuton me nxënësit për pozitat e gruas shqiptare në të kaluarën, por edhe në kohën tonë.

Detyrë shtëpie:

Orienton nxënësit që të mbledhin informacion (të dhëna, legjenda, fotografi, vizatime) nga prindërit apo të afërmit e tyre në lidhje me pozitën e gruas në vendlindjen e tyre në të kaluarën dhe tani.

Kompetenca e Vlerësimit:

Mësues-i/ja vlerëson të lexuarit me shprehësi dhe të menduarit kreativ.

Vërejtjet e mësues-it/es

Lasgush Poradeci

KROI I FSHATIT TONË

Planifikim mësimi

Lënda: Letërsi

Klasa: VI

Tema mësimore: Lasgush Poradeci "Kroi i fshatit tonë"

Lloji: poezi lirike

Rezultatet e të nxëniet të kompetencave sipas temës mësimore. Nxënësi/ja:

- Kupton dhe evidenton karakteristikat e poezisë lirike.
- ndërvepron në tekst për të mbushur ato hapësira që teksti ka lënë për të.
- zhvillon aftësinë asociative, për të ndërlidhur këtë tekst me tekste të tjera që kanë të njëjtat motive.
- njeh llojet e ndryshme të strofave dhe të figurave letrare (onomatopenë, antitezën)

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: nxitja e të menduarit me asociacione dhe qasje krahasimtare; nxitja e punës individuale dhe asaj në grup.

Organizimi i orës së mësimi

Veprimtaria e mësues-it/es:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme

Etapa e parë:

Mësues-i/ja kërkon të dijë nëse ka pasur vështirësi në të kuptuarit e tekstit të orës së mëparshme; kërkon nga nxënësit nëse ka pyetje për tekstin apo rreth tij. Kontrollon detyrat, nëpërmjet leximit të tyre nga vetë nxënësi dhe i vlerëson ato në bashkëveprim me mendimin e nxënësve të tjerë, duke e argumentuar vlerësimin. Kërkon nga nxënësit t'i bëjnë pyetje njëri-tjetrit në lidhje me mësimin, duke vlerësuar njëkohësisht si natyrën dhe formulimin e pyetjes, ashtu edhe formulimin e përgjigjes.

Etapa e dytë:

Mësues-i/ja rikujton karakteristikat e poezisë së peizazhit:

poezia e peizazhit

- I këndon bukurive të natyrës
- e ka natyrën objekt të vetin estetik
- nuk ka mesazh tjetër përveç atij estetik

Mësues-i/ja flet për motivin e punës në fshat; flet për rolin që kishte femra (vasha) në jetën e fshatit te poezia e Çajupi. Pastaj shkruan në tabelë titullin e poezisë "Kroi i fshatit tonë" dhe emrin e autorit. U shpjegon nxënësve se kush është Lasgush Poradeci, duke dhënë të dhëna për jetën dhe veprën e tij.

Mësues-i/ja lexon me ritëm, dhe duke bërë pauzat e duhura gjatë leximit;

- tërheq vëmendjen e nxënësve në lidhje me strofën që mendon se mbart peshën kuptimore të tekstit;
- shpjegon motivet dhe temën qendrore që ka teksti;
- shpjegon lidhjet e këtij teksti me poezinë popullore (duke shpjeguar se zgjedhja e kroit si vend takimi i vashës me djalin është motiv i huazuar nga poezia popullore.)
- shpjegon vlerën e figurave, domethënien e tyre dhe origjinën.

Mësues-i/ja orienton nxënësit të lexojnë zinxhir, njëri pas tjetrit, me diksionin e duhur poezinë. Udhëzon nxënësit të nënvizojnë fjalët apo shprehjet që nuk i kanë dëgjuar më parë apo nuk ua dinë kuptimin.

Bën shpjegimin e tyre dhe argumenton funksionin që ato kanë në tekst.

- Mësues-i/ja udhëzon nxënësit që të punojnë në grupe, duke bërë krahasimin e poezisë së Lasgushit me atë të Çajupit;
- Nxiti diskutimin e nxënësve rreth përmbajtjes së tekstit;
- Evidenton disa prej figurave (duke shpjeguar figurat e reja që nxënësit nuk i dinë) dhe kërkon nga nxënësit të gjejnë të tjera në tekst;
- U kërkon nxënësve të krahasojnë strofën të Lasgushi me atë të Çajupi;
- Orienton punën e nxënësve për t'i dhënë përgjigje ushtrimeve dhe pyetjeve nga 1-10, në librin e nxënësit;
- U kërkon nxënësve të formojnë dy grupe dhe secili të analizojë dy strofat e para (që kanë në qendër vashën) me dy strofat e fundit (që kanë në qendër trimin/djalin).

Detyrë

- Udhëzon nxënësit që të nënvizojnë fjalët a shprehjet me të cilat autori përshkruan bukurinë e vajzave dhe ta krahasojnë me një tekst tjetër të krijimtarisë popullore, ku përshkruhet bukuria e vajzës të zonës së tyre.

Kompetenca e Vlerësimit:

Mësues-i/ja vlerëson të menduarit e pavarur dhe kreativ të nxënësit.

Vërejtjet e mësues-it/es

Aleksa Shantiq

RRINI KËTU ...!

Planifikim mësimi

Lënda: Letërsi

Klasa: VI

Tema mësimore: Aleksa Shantiq "Rrini këtu ...!"

Lloji: poezi lirike

Rezultatet e të nxëniet të kompetencave sipas temës mësimore. Nxënësi/ja:

- lexon rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur poezinë;
- u përgjigjet pyetjeve që zbërthejnë tekstin poetik;
- analizon gjendjen shpirtërore të heroit lirik, kur flet për mërgimin;
- analizon fenomenin e largimit të heroit lirik nga vendi i tij;
- bën analogji me situatën në të cilën ndodhet vendi i tij përballë këtij fenomeni;
- analizon gjuhën figurative që përdor poetja.

Metoda e veprimtarisë me nxënësit: stuhi mendimesh; diskutim dhe punë në grupe

Organizimi i orës së mësimi

Veprimtaria e mësues-it/es:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme

Etapa e parë:

Mësues-i/ja bën kontrollin e njohurive nëpërmjet pyetjeve që zbulojnë sa është kuptuar teksti i Lasgushit; kontrollon dhe vlerëson detyrat që u ka lënë nxënësve për të bërë. Diskuton me ta në lidhje me shembujt që nxënësit kanë sjellë. Bën pyetje rreth figurave letrare që gjenden në tekst. Kërkon nga nxënësit që t'i ilustronjë fjalët e reja me fjali të krijuara prej tyre.

Mësuesja flet për fenomenin e mërgimit, çfarë pasojash ka; kush e vuan më shumë; pse duhet të mendojmë për vendin, për tokën, për prindërit tanë; pse është e hidhur "kafshata në dhe të huaj". Mësuesja kërkon nga nxënësit të shprehin mendimin e tyre për këtë fenomen dhe të bëjnë ilustrime me përvojat personale të rrethin familjar apo shoqëror të tyre.

Etapa e dytë:

Mësuesja shkruan në tabelë titullin e poezisë "Rrini këtu...!" dhe emrin e autores.

U shpjegon nxënësve se kush është Aleksa Shantiq, duke dhënë të dhëna për jetën dhe veprën e saj.

Mësues-i/ja dhe dy - tre nxënës, lexojnë në mënyrë shprehëse tekstin. Nxënësit e tjerë ndjekin dhe mbajnë shënim fjalët/ shprehjet apo strofat që janë bërthama kuptimore e poezisë.

Mësues-i/ja shpjegon fjalët dhe shprehjet e reja dhe ato figurative.

Mësues-i/ja bën pyetje rreth përmbajtjes së poezisë:

1. Kush flet në këtë poezi dhe çfarë sugjeron ?
2. Kë konsideron nënë heroit lirik në këtë pjesë?
3. Pse u kujton varret e stërgjyshërve?
4. Çfarë e lidh njeriun me vendlindjen?
5. Pse vendi ka nevojë për njerëzit e tij?
6. Pse është e hidhur buka në dheun e huaj?

Mësues-i/ja orienton punën e nxënësve për t'i dhënë përgjigje disa ushtrimeve që janë në librin e nxënësit:

Në lidhje me pyetjen 1, u kërkon nxënësve të shprehin lirshëm për emocionet që kanë ndierë gjatë leximit të poezisë.

Në lidhje me pyetjen 3, orienton nxënësit për të formuluar temën qendrore të poezisë dhe nëntemat e saj.

Për pyetjen 4, identifikon bashkë me nxënësit subjektin/ heroin lirik.Ndihmon nxënësit për të kuptuar arsyen e përsëritjes së strofës së parë në fund të poezisë.

Për pyetjen 6, kërkon nga nxënësit që të formulojnë mesazhin e poezisë.

Kërkon nga nxënësi që të lidhin temën e poezisë me rastet nga përvojat e tyre familjare apo shoqërore.

Detyrë

Mësues-i/ja udhëzon nxënësit të gjejnë në bibliotekën e tyre familjare apo të kërkojnë nga të rriturit t'u thonë një poezi (popullore apo të kultivuar) apo një tekst në prozë me këtë temë dhe të diskutojnë për të përbashkëtat që kanë me poezinë "Rrini këtu...!" të Shantiqit

Kompetenca e Vlerësimit:

Mësues-i/ja vlerëson të menduarit e pavarur dhe kreativ të nxënësit.

Vërejtjet e mësues-it/es

KAPITULLI II

Ibrahim Kadriu

LIBRI PËR PRINCIN E LUMTUR

Planifikim mësimi

Lënda: Letërsi

Klasa: VI

Tema mësimore: Ibrahim Kadriu "Libri për princin e lumtur"

Lloji: tregim

Rezultatet e të nxënësve të kompetencave sipas temës mësimore. Nxënësi/ja:

- është në gjendje të ritregojë bukur fabulën;
- lexon tekstin dhe projektin veten te personazhi që do të donte të ishte;
- ndërton pyetje dhe u përgjigjet pyetjeve rreth tekstit;
- Evidenton pjesët që tregojnë dëshirën e madhe të personazhit;
- përcakton funksionin e rrëfimtari (narratorit) dhe të personazhit në tregim.

Metoda e veprimtarisë me nxënësit: nxitja e leximit me role; puna në grup; instruktimi për lexim aktorial.

Organizimi i orës së mësimi

Veprimtaria e mësues-it/es:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Etapa e parë:


Mësues-i/ja u kërkon nxënësve të thonë nëse dinë ndonjë tregim apo përrallë që ka si personazh kryesor princin e lumtur apo që flitet rreth tij.

Mësues-i/ja kërkon nga nxënësit që të ritregojnë, në mënyrë të ngjeshur, fabulën e tregimit apo përrallës që përmendën. Mësues-i/ja bën lidhjen ndërmjet asaj çfarë u diskutua me temën e re që do të shpjegojë.

Etapa e dytë:

Mësues-i/ja shkruan në tabelë titullin e tregimit "Libri për princin e lumtur" dhe emrin e autorit. Jep një informacion të shkurtër për jetën dhe krijimtarinë e Ibrahim Kadriut.

Mësues-i/ja u tregon nxënësve tre katër pikat më të rëndësishme të fabulës.



Mësues-i/ja lexon dy paragrafët e parë, pastaj zgjedh tre nxënës dhe i udhëzon të lexojnë sipas roleve që u përcakton: rolin e rrëfimtari, të djalit dhe të babait të djalit.

- Mësues-i/ja orienton nxënësit që të shënojnë paragrafët hyrës, paragrafët zhvillues dhe mbyllës të tregimit.
- Mësues-i/ja formulon vetë një prej ideve që përçon tekstin, pastaj zgjedh dy nxënës dhe kërkon që secili prej tyre të shkruajë nga 2 ide për tekstin. Mësues-i/ja u kërkon nxënësve të tjerë që të vlerësojnë se cilat ide janë më të gjeturat dhe të shprehura më mirë.
- Mësues-i/ja orienton nxënësit për të zbërthyer pyetjet e shënuara në librin e nxënësit.
- Mësues-i/ja nxit nxënësit të tregojnë sesi e kanë përjetuar ngjarjen e rrëfyer në këtë tregim. Pyetja 1.
- Mësues-i/ja bën pyetjet:
 - Si ju duket atmosfera ku njihet babai me djalin?
 - Pse i ikën buzëqeshja nga fytyra të huajit?

1. sepse djali ia lustroi keq këpucët

2. sepse djali i foli keq

3. sepse njohu të birin

- Pse shtang vogëlushi, kur gjendet në krahët e të huajit?
- Si ju duket vendimi i djalit për të fituar paratë, për të blerë librin, a do të vepronit dhe ju ashtu?

Mësues-i/ja orienton nxënësin që të kuptojnë ndryshimet në mes autorit, narratorit dhe personazhit, duke u ndalur në përcaktimet:

1. Autori = është ai që e shkruan librin.

2. Narratori = është ai që e rrëfen ngjarjen (narratori mund të jetë personazh kryesor ose dytësor në ngjarjet që rrëfohen, por edhe mund të mos jetë fare i përfshirë në ngjarje).

3. Personazh = është ai që merr pjesë në ngjarje si protagonist apo si një prej pjesëmarrësve në ngjarje.

Mësues-i/ja orienton nxënësit drejt dramatizimit të kësaj pjese. Ndan pjesën sipas personazheve dhe zgjedh katër nxënës për të luajtur rolin e djalit, të nënës, babait dhe narratorit.

Detyrë:

Mësuesi udhëzon nxënësit që të rishkruajnë tregimin duke ruajtur elementet më të rëndësishme të tij.

Kompetenca e Vlerësimit:

Mësues-i/ja vlerëson të menduarit e pavarur dhe kreativ të nxënësit.

Vërejtjet e mësues-it/es

FUQIA E MUJIT

Planifikim mësimi

Lënda: Letërsi

Klasa: VI

Tema mësimore: "Fuqia e Mujit"

Lloji: Stripi

Rezultatet e të nxënës të kompetencave sipas temës mësimore. Nxënësi/ja:

- lidh në mënyrë logjike figurën me tekstin;
- formulon idetë dhe mesazhet që përçon ilustrimi dhe teksti;
- lexon tablonë përtej fjalëve;
- evidenton përparësitë apo mangësitë e imazhit në raport me fjalën.

Metoda e veprimtarisë me nxënësit: nxitja e imagjinatës në të lexuarit e një teksti të ilustruar; nxitja e bashkëveprimit të shqisës së të parit me atë të kuptuarit

Organizimi i orës së mësimi

Veprimtaria e mësues-it/es:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit

Etapa e parë:

Mësues-i/ja pyet nxënësit: nëse u pëlqen më shumë të lexojnë nëpërmjet imazheve apo nëpërmjet fjalëve? Nëse mendojnë se imazhet figurative e ngacmojnë më shumë imagjinatën apo e kundërta. Pse? Mësues-i/ja pyet nxënësit se si e kuptojnë shprehjen se një fotografi vlen më shumë se sa njëmijë fjalë?

Mësues-i/ja pyet nxënësit nëse kanë lexuar ndonjë nga historitë e librit të *Tin Tinit*, nëse po, atëherë u kërkon nxënësve të rrëfejnë mbresat që kanë nga ai lexim.

Etapa e dytë:

Mësues-i/ja shkruan në tabelë titullin e pjesës "Fuqia e Mujit" dhe shpjegon natyrën e temës. Mësues-i/ja udhëzon nxënësit që ta lexojnë fillimisht me sy çdo tablo dhe pastaj ta lidhin me tekstin e shoqëruar me fjalë. Mësues-i/ja diskuton me nxënësit për dy përvojat e të lexuarit dhe bën pyetje:

- A lidhen domethënia e përftuar nga leximi vizual me leximin e fjalëve?
- Cili i jep më liri imagjinatës dhe pse?
- A është më argëtuese kjo mënyrë e të shprehurit sesa ajo në një lloj të njohur letrar?
- Si e kërkojnë zakonisht tekstin e shkruar stripet:
 - a. të shkurtër dhe përmbledhës;
 - b. të gjatë, përshkrues?;
 - c. me shprehje të një ligjërimi të ngritur?;
 - d. me shprehje të një ligjërimi të përditshëm?;(nxënësi të zgjedhë dy alternativa)

Mësues-i/ja udhëzon nxënësit të shohin me vëmendje ilustrimet dhe tekstin e shkruar, më pas të tregojnë se çfarë ruan stripi nga teksti burimor (nga tregimi të cilit i referohet).

Mësues-i/ja udhëzon nxënësit në zbërthimin e pyetjeve nga libri i nxënësit. Bashkë me nxënësit i japin përgjigje pyetjes 2, e cila lidhet me përshtypjet që lë stripi dhe zgjedhjen e alternativave; pyetjes 3, që kërkon ritregimin e ngjarjeve me fjalët e nxënësit; pyetjes 4 dhe 5.

Detyrë:

Mësuesi udhëzon nxënësit që të bëjnë edhe ato në një dyfletësh një strip për tregimin "Libri për princin e lumtur" dhe ta diskutojnë në klasë.

Mësues-i/ja u kujton nxënësve që të punojnë me kujdes, sepse stripi më i mirë do të vlerësohet me notën maksimale dhe do të ekspozohet në ambientet e shkollës.

Kompetenca e Vlerësimit:

Mësues-i/ja vlerëson të menduarit e pavarur dhe kreativ të nxënësit.

Vërejtjet e mësues-it/es

J.K. Rowling

HARRI POTER

Planifikim mësimi

Lënda: Letërsi

Klasa: VI

Tema mësimore: J.K. Rowling "Harri Potter"

Lloji: roman

Rezultatet e të nxënësve të kompetencave sipas temës mësimore. Nxënësi/ja:

- lexon rrjedhshëm dhe ritregon në mënyrë e duhur fabulën;
- dallon elementet reale dhe elementet fantastike në tekst;
- tregon pikat kyçe të ngjarjes që rrëfëhet në tekst;
- identifikon fjalët e personazheve nga ato të narratorit

Metoda e veprimtarisë me nxënësit: nxitja e të menduarit kreativ, diskutim i lirë mbi librin dhe filmin e Harri Poterit.

Organizimi i orës së mësimi

Veprimtaria e mësues-it/es:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Etapa e parë:

Mësues-i/ja kërkon të dijë, nëse nxënësit kanë lexuar ndonjë nga librat për Harri Poterin dhe cilin kanë lexuar. Pastaj pyet nëse ata i kanë parë filmat e realizuar mbi bazën e atyre librave? Mësues-i/ja kërkon mendimin e nxënësve, nëse u ka pëlqyer më shumë libri apo ekranizimi i tij dhe diskuton me ta për arsyet.

Etapa e dytë:

Mësuesja shkruan në tabelë titullin e poezisë "Rrini këtu...!" dhe emrin e autores.

Mësues-i/ja shkruan në tabelë titullin e librit "Harri Potter" dhe të pjesës "Xhama që zhduken" që do të trajtohet në këtë orë.

- Flet në mënyrë të përmbledhur për jetën dhe krijimtarinë e autores së librit J.K. Rowling.
- Mësues-i/ja u tregon në mënyrë të përmbledhur ngjarjen, duke u përqendruar te elementët kyç të saj dhe pastaj kërkon nga fëmijët që ta lexojnë me zë dhe me radhë tekstin.
- Pas çdo paragrafi mësues-i/ja zgjedh nga një nxënës që ta përmbledhë me një fjali të shkurtër kuptimin e pjesës së lexuar.
- Mësues-i/ja shpjegon raportin e personazheve me njëri-tjetrin dhe kërkon nga nxënësit të tregojnë se si sillen Dadli dhe Persi me Harrin.
- Mësues-i/ja udhëzon nxënësit në zhvillimin e pyetjeve nga libri i nxënësit:
- Mësues-i/ja u kërkon nxënësve të shënojnë në secilën anë të tabelës argumentet për përparësitë që ka të lexuarit e librit nga të të shikuarit e filmit. Pyetja 1 nga libri i nxënësit

	Përparësitë e librit	Përparësitë e filmit
Harri Potter		

- Mësues-i/ja u kërkon nxënësve të rendisin në mënyrë kronologjike ngjarjet kryesore të fabulës. Pyetja 2 nga libri i nxënësit.

- Mësuesja u kërkon nxënësve që të përshkruajnë takimin e Harri Poterit me gjarprin.
- Mësues-i/ja u kërkon nxënësve që të plotësojnë në tabelë elementet reale dhe fantastike që ka tregimi. Pyetja 10 nga libri i nxënësit.
- Mësues-i/ja u shpjegon nxënësve kërkesën e detyrave të shtëpisë.

Kompetenca e Vlerësimit:

Mësues-i/ja vlerëson të menduarit e pavarur dhe kreativ të nxënësit.

Vërejtjet e mësues-it/es

Mimoza Ahmeti

GJYSHES

Planifikim mësimi

Lënda: Letërsi

Klasa: VI

Tema mësimore: Mimoza Ahmeti "Gjyshes"

Lloji: Poezi lirike

Rezultatet e të nxënësve të kompetencave sipas temës mësimore. Nxënësi/ja:

- lexon me shprehësi një tekst lirik;
- gjen temën dhe motivet e tekstit;
- interpreton tekstin, duke respektuar pauzat dhe theksat logjike;
- shkruan një poezi me të njëjtin temë.

Metoda e veprimtarisë me nxënësit: nxitja e të menduarit kreativ, diskutim i lirë mbi librin dhe filmin e Harri Poterit.

Organizimi i orës së mësimi

Veprimtaria e mësues-it/es:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Etapa e parë:

Mësues-i/ja pyet nxënësin se: çfarë është për ta gjyshja? Si i kanë marrëdhëniet me gjyshen e tyre? Kush u ka treguar përralla kur kanë qenë të vegjël dhe kush i ka mbrojtur nga qortimet e prindërve? Si u duket gjyshja: e dhembshur apo e sertë?

Mësues-i/ja u kërkon nxënësve të shkruajnë me disa fjalë karakteristikat e gjysheve të tyre dhe nxjerr në tabelë një nxënës që të vizatojë portretin e gjyshes së tij.

Etapa e dytë:

Mësues-i/ja shkruan në tabelë titullin e poezisë "Gjyshja" dhe emrin e autores. Bën një përshkrim të shkurtër të jetës dhe veprimtarisë së Mimoza Ahmetit, autores së poezisë.

Mësues-i/ja lexon në mënyrë interpretuese tekstin, duke u ndalur te shenjat që sugjeron teksti, si pauza, fundi i vargjeve, fjalët kyçe etj.

Mësues-i/ja sugjeron dy nxënës që ta recitojnë bukur poezinë.

Mësues-i/ja nxit përjetimet dhe interpretimin individual, i cili mbështetet në kapacitetet dhe kulturat e leximit të secilit nxënës.

Mësuesi u kërkon nxënësve të nënvizojnë fjalët e reja dhe fjalët me kuptim të figurshëm.

Mësues-i/ja u shpjegon nxënësve fjalët dhe kuptimet e fjalëve të figurshme.

Mësues-i/ja u kërkon nxënësve që të flasin për temën e poezisë.

Mësues-i/ja sugjeron ndarjen e vargjeve sipas motiveve që sugjeron poezia.

Mësues-i/ja sjell një tekst tjetër që flet për dashurinë për gjyshen dhe pasi e lexon u kërkon nxënësve që të shënojnë fjalët që shprehin karakteristika të njëjta apo të përafërta për figurën e gjyshes.

Mësues-i/ja u shpjegon nxënësve dallimin në mes një poezie dhe një teksti të kompozuar.

Mësues-i/ja udhëzon nxënësit në zberthimin e pyetjeve 2,3,4,5, 7 që ka libri i nxënësit.

Mësues-i/ja organizon një minikonkurs me temë "gjyshja ime" dhe u kërkon nxënësve të shkruajnë dy strofa dhe pastaj ta lexojnë dhe të vlerësohen sipas vlerës estetike që përcjell teksti.

Kompetenca e mësuesit:

Mësuesi duhet të dijë të vlerësojë nxënësit sipas veçantive të tyre.

Vërejtjet e mësues-it/es

Kapitulli III

Populli

PARAJA E FITUAR ME DJERSË

Planifikim mësimi

Lënda: Letërsi

Klasa: VI

Tema mësimore: Populli "Paraja e fituar me djersë"

Lloji: tregim popullor

Rezultatet e të nxënësve të kompetencave sipas temës mësimore. Nxënësi/ja:

- Mësohet të evidentojë karakteristikat e tregimit popullor/ përrallave;
- analizon elementet e kompozimit të përrallës;
- mëson të identifikojë temën dhe të nxjerrë idetë dhe mesazhet e tekstit;
- kupton vlerën didaktike që kanë këto lloj tregimesh.

Metoda e veprimtarisë me nxënësit: nxitja e të menduarit sintetik dhe diskutim i lirë

Organizimi i orës së mësimi

Veprimtaria e mësues-it/es:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Etapa e parë:

Mësues-i/ja pyet nxënësit se çfarë dinë rreth tregimeve popullore: si janë të ndërtuara ato? Si është struktura e tyre? Si veprojnë personazhet në to? Si përcillet mesazhi dhe idetë? Pse thuhet se përçojnë përvojën e jetës? Mësues-i/ja u kërkon nxënësve të thonë titullin dhe, shkurtimisht, fabulën e ndonjëres prej tregimeve të këtij lloji, që ato dinë.

Etapa e dytë:

Mësues-i/ja shkruan në tabelë titullin e pjesës "Paraja e fituar me djersë" dhe u shpjegon nxënësve se pse quhet tregim popullor.

Mësues-i/ja i njuh nxënësit me fabulën e pjesës, duke e treguar atë, përmbledhtazi, me katër – pesë fjali dhe duke e lënë të treguarin në pikën më interesante të tij.

Mësuesi udhëzon nxënësit që të lexojnë pjesë- pjesë tekstin dhe pas çdo pjesë një nxënës të formulojë me një fjali domethënien e pjesës.

Pasi ta kenë lexuar tekstin, mësuesi u kërkon nxënësve të nënvizojnë me një vijë paragrafët kyç për zhvillimin e ngjarjes dhe me dy vija paragrafët më pak të rëndësishëm, që nuk ndikojnë në ecurinë e ngjarjeve të tekstit.

Mësues-i/ja u kërkon nxënësve të përshkruajnë profilin e secilit personazh: babait, djalit dhe nënës.

babai

a) _____

Djali

b) _____

nëna

c) _____

Mësuesi-i/ja u kërkon nxënësve të shpjegojnë, se si e kuptojnë ata veprimin e nënës:

1. Të dobishëm
2. Të dëmshëm
3. Ndihmues
4. Frenues

dhe të argumentojnë zgjedhjet e tyre.

Mësues-i/ja u kërkon nxënësve të shpjegojnë se si e kuptojnë veprimin e të atit në raport me djalin.

Mësues-i/ ja kërkon nga nxënësit që të shpjegojnë lidhjen në mes titullit të pjesës dhe paragrafit të fundit të saj.

Mësues-i/ja u kërkon nxënësve që të formulojnë disa prej mesazheve që transmeton pjesa.

Mësues-i/ja u kërkon nxënësve që të rishkruajnë tekstin, duke ruajtur elementet që ata i konsiderojnë më të rëndësishme për tekstin.

Mësuesi u kërkon nxënësve që t'u përgjigjen në mënyrë kreative pyetjeve 1, 2, 3, 4 të librit të nxënësit.

Mësuesi/ja udhëzon në zbërthimin e ushtrimeve 7,8,9,10, 12, 13 që përmban libri i nxënësit

Detyrë

Mësuesi/ja u kërkon nxënësve që të hartojnë një tregim me ndodhi e personazhe nga jeta e përditshme.

Kompetenca e Vlerësimit:

Mësues-i/ja vlerëson aftësinë e nxënësve për të bërë analizë dhe për t'u shprehur bukur.

Vërejtjet e mësues-it/es

MËMA

Planifikim mësimi

Lënda: Letërsi

Klasa: VI

Tema mësimore: Aleksandër Stavre Drenova- Asdreni "Mëma"

Lloji: poezi

Rezultatet e të nxënit të kompetencave sipas temës mësimore. Nxënësi/ja:

- lexon me emocion dhe shprehësi një tekst lirik;
- gjen temën dhe motivet e tekstit;
- reciton tekstin, duke respektuar pauzat dhe theksat logjikë;
- arrin të shkruajnë një poezi me të njëjtin temë

Metoda e veprimtarisë me nxënësit: nxitja e shkrimit krijues, leximit emocional dhe të recitimit të poezisë.

Organizimi i orës së mësimi


Veprimtaria e mësues-it/es:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Etapa e parë:

Mësues-i /ja u kërkon nxënësve të tregojnë nëse kanë shkruar ndonjëherë poezi për nënën. Mësues-i/ja u kërkon nxënësve ta recitojnë përpara klasës poezinë që ata kanë shkruar ose që kanë mësuar më përpara.

Mësues-i/ja udhëzon nxënësit që të zgjedhin dhe të shkruajnë në fletore fjalët që do të donin të përdornin për të përshkruar figurën e nënës së tyre. Pasi t'i lexonte secili nxënës, i udhëzon ata të shkruajnë në tabelë fjalët më të bukura (në aspektin estetik) dhe me ngarkesë më të madhe emocionale.



Etapa e dytë:

Mësues-i/ja shkruan në tabelë titullin e poezisë "Mëma" dhe emrin e autorit. Ajo flet shkurtimisht për jetën dhe krijimtarinë e Asdrenit.

Mësues-i/ja lexon dy strofat e para dhe pastaj zgjedh katër nxënës që të lexojnë nga një strofë. U kërkon nxënësve që lexuan, që të përcaktojnë fjalën kyç të strofës së tyre dhe të përmbledhin me një fjali vlerësimin që i bëhet nënës në atë strofë.

- Mësues-i/ja u kërkon nxënësve të klasës që të nënvizojnë fjalët që nuk ua dinë kuptimin dhe fjalët me kuptim të figurshëm.
- Mësues-i/ja shpjegon kuptimin e fjalëve të reja dhe përdorimin e figurave letrare. Shpjegon dhe ilustron figurën e epitetit, p.sh. fjalë e shenjtë; yll qiellor... dhe metaforës rreze drite; ëngjëll roje; bir skëterre. Komenton funksionin e këtyre figurave në poezi.
- Mësues-i/ja nxit nxënësit të shprehin ndjesinë e përftuar nga leximi i një poezie të tillë.
- U kërkon nxënësve të flasin për mesazhet dhe motivet e kësaj poezie.
- U kërkon nxënësve të shpjegojnë pse ka ngarkesë të lartë emocionale kjo lloj poezie.
- U kërkon nxënësve të veçojnë fjalët apo vargjet që do të donin t'i kishin shkruar vetë ata.
- Mësues-i/ja udhëzon nxënësit që të gjejnë se në cilën strofë shprehet dashuria e pakushtëzuar e nënës dhe të shpjegojnë si e kuptojnë ata këtë.

- Mësues-i/ja shpjegon muzikalitetin që përmban poezia dhe rolin e rimës dhe ritmit në këtë tekst.
- Mësues-/ja u kërkon nxënësve të nënvizojnë tingujt që përsëriten brenda një vargu a strofe dhe u shpjegon atyre funksionin e përsëritjes së tingujve.
- Mësues-i/ja u flet nxënësve për llojin e vargut 8- rrokësh, duke i ndihmuar se si ta gjejnë atë.
- Mësuesi udhëzon nxënësit në zbërthimin e kërkesave që paraqesin ushtrimet 3,4, 6, 7, 8, 9 e 10.

Detyrë:

- Mësuesi udhëzon nxënësit që të shkruajnë një poezi ose një prozë poetike që t'i kushtohet nënës. U tërheq vëmendjen nxënësve që të kenë një fjalor poetik sa më të zgjedhur.

Kompetenca e Vlerësimit:

Mësues-i/ja vlerëson të menduarit e pavarur dhe kreativ të nxënësit.

Vërejtjet e mësues-it/es

Molier

BORGJEZI FISNIK

Planifikim mësimi

Lënda: Letërsi

Klasa: VI

Tema mësimore: Molier "Borgjezi fisnik"

Lloji: komedi

Rezultatet e të nxënësve të kompetencave sipas temës mësimore. Nxënësi/ja:

- arrin të dallojë karakteristikat e komedisë;
- gjen temën dhe të gjykojë për mesazhet e pjesës;
- evidenton veset apo të metat e shoqërisë që shigjeton autori;
- interpreton tekstin, duke respektuar leximin aktorial dhe me role.

Metoda e veprimtarisë me nxënësit: nxitja e të menduarit kreativ, leximi me role dhe interpretimi aktorial.

Organizimi i orës së mësimi

Veprimtaria e mësues-it/es:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Etapa e parë:

Mësues-i/ja kërkon nga nxënësit të thonë se çfarë dinë për komedinë, duke bërë pyetjet:

Çfarë është komedia? Ku ndryshon komedia nga tragjedia? Cilat elemente përdor ajo për të na bërë për të qeshur? Çfarë temash përdoren përgjithësisht në komedi? A kanë parë ndonjë komedi në teatër apo në ekran? A kanë luajtur ndonjëherë në ndonjë shfaqje komedie të improvizuar në shkollë?

- Mësues-i/ja u kërkon nxënësve të përmendin ndonjë titull komedie që kanë lexuar apo parë dhe emrin e autorit të saj.

Etapa e dytë:

Mësues-i/ja shkruan në tabelë titullin e komedisë "Borgjezi fisnik" dhe emrin e autorit, duke dhënë në mënyrë të përmbledhur jetën, krijimtarinë dhe rolin e Molierit në dramaturgjinë (komedinë) franceze dhe atë botërore.

Mësues-i/ja shpjegon se si operohet me komedinë. Shpjegon funksionin e **roleve, didaskalive dhe efekteve skenike**.

Mësuesja shpjegon përmbledhtazi përmbajtjen e pjesës, duke u ndalur te ngjarjet dhe situatat që mbartin kuptimin e tekstit dhe shkaktojnë efektet komiken tekst.

Mësues-i/ja zgjedh disa nxënës dhe ndan rolet. Nxënësit lexojnë me interpretim rolin e tyre. Lexohet i plotë teksti.

Mësuesi pyet klasën se si ju duk interpretimi i shokëve dhe a përputhej interpretimi i tyre me imazhin që ato kishin për personazhet e interpretuara.

Mësuesi bën pyetje rreth mënyrës se si është kuptuar pjesa:

- A i përshtatet titulli i veprës figurës së zotit Zhurden?
- Cili paraqet në këtë pjesë tiparet e vërteta të fisnikut zoti Zhurden apo Kleonti?
- Cilat janë elementet që e bëjnë qesharake figurën e Zhurdenit?

Mësues-i/ja kërkon nga nxënësit që të veçojnë pjesën që ka ligjërimin më të bukur, sipas tyre, dhe që bart mesazh të fortë. Mësues-i/ja kërkon që nxënësit ta argumentojnë zgjedhjen e tyre. Mësues-i/ja u kërkon nxënësve që të tregojnë se rolin e cilit personazh do të donin të luanin dhe pse?

Mësues-i/ja diskuton me nxënësit në lidhje me vesin që Molieri godet në këtë komedi. Dhe pyet nxënësit nëse shfaqet dhe si shfaqet ai sot?

Mësues-i/ja udhëzon nxënësit për të zbërthyer ushtrimet në librin e nxënësit.
Mësues-i/ja udhëzon nxënësit që të lexojnë një pjesë tjetër nga kjo komedi dhe të ndajnë rolet. Ta mësojnë mirë dhe ta interpretojnë përpara shokëve në orën në vazhdim.
Mësues-i/ja u tërheq vëmendjen nxënësve se do të vlerësohen edhe për mënyrën e interpretimit të rolit.

Kompetenca e Vlerësimit:

Mësues-i/ja vlerëson të menduarit e pavarur dhe kreativ të nxënësit.

Vërejtjet e mësues-it/es

Ismail Kadare

POEZIA E PARË

Planifikim mësimi

Lënda: Letërsi

Klasa: VI

Tema mësimore: Ismail Kadare "Poezia e parë"

Lloji: Tregim

Rezultatet e të nxënës të kompetencave sipas temës mësimore. Nxënësi/ja:

- lexon rrjedhshëm dhe ritregon në mënyrë të ngjeshur përmbajtjen;
- tregon pikat kyçe të ngjarjes që rrëfëhet në tekst;
- identifikon fjalët e personazheve nga ato të rrëfimtari;
- identifikon idetë dhe mesazhin e tekstit.

Metoda e veprimtarisë me nxënësit: nxitja e të menduarit kreativ, nxitja e diskutimeve dhe e punës në grup.

Organizimi i orës së mësimi

Veprimtaria e mësues-it/es:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Etapa e parë:

Mësues-i/ja pyet nxënësit, nëse kanë shkruar ndonjëherë poezi apo prozë? Çfarë teme ka pasur? Kujt ia kanë treguar poezinë apo prozën e parë? A kanë botuar ndonjëherë në revistat e shkollës? Po në gazetatat apo revistat lokale? A e mbajnë mend titullin e krijimit të parë? Mësues-i/ja pyet nxënësit, nëse e kanë dëgjuar emrin e Ismail Kadaresë? Çfarë dinë për këtë shkrimtar dhe çfarë kanë lexuar nga ai?

Etapa e dytë:

Mësues-i/ja shkruan në tabelë titullin e pjesës "Poezia e parë" dhe emrin e autorit. Pastaj zgjeron njohuritë e nxënësve për këtë shkrimtar të shquar të letërsisë shqipe.

Mësues-i/ja prezanton në mënyrë të përmbledhur përmbajtjen e pjesës dhe pastaj u kërkon nxënësve që ta lexojnë në heshtje atë dhe të nënvizojnë me **një vijë dialogun** ndërmjet personazheve dhe **me dy vija fjalët e rrëfimtari**.

Mësues-i/ja u kërkon nxënësve të përshkruajnë mënyrën se si i përfytyrojnë personazhin e teto Haxhekos, në bazë të fjalëve dhe shprehjeve që ajo përdor.

Mësues-i/ja nxit një situatë për diskutim, duke pyetur nxënësit nëse është e mundur që të shkruhet një vepër letrare nga dy vetë dhe pastaj ndërton një tabelë me argumentet pro dhe kundër që propozojnë nxënësit.

Argumentet pro	Argumentet kundër

Mësues-i/ja u kërkon nxënësve që të gjejnë në tekst pjesën, që i ka bërë për të qeshur dhe u shpjegon atyre elementet që e shkaktojnë atë.

Mësues-i/ja nxit nxënësit të diskutojnë në lidhje me reagimin e babait për botimin e poezisë. Ajo shtron pyetjet: *A ju duket i drejtë reagimi i babait ndaj djalit? Si mendoni se duhej të sillej ai? A është i gabuar veprimi i djalit? Pse mendoni ju se është nxehur babai? Si do të ndjeheshit ju po të ishit në një situatë të tillë?*

Mësuesja shpjegon kuptimin e fjalëve të reja dhe u kërkon nxënësve që t'i ilustrojnë me fjali të krijuara prej tyre.

Mësues-i/ja orienton nxënësit në zbërthimin e pyetjeve 4,5,6,8,9.

Detyrë

Mësues-i/ja e ndan tekstin në pjesë dhe e përshtat për dramatizim në katër role:

1. Roli i rrëfimtari
2. Roli i llirit
3. Roli i babait
4. Roli i teto Haxhekos

Pastaj zgjedh katër nxënës të cilëve u shpërndan pjesët sipas roleve që ka përcaktuar dhe dy nxënës të tjerë për të ndërtuar skenografinë. Pastaj udhëzon nxënësit që t'i mësojnë dhe interpretojnë pjesët për orën në vijim.

Kompetenca e Vlerësimit:

Mësues-i/ja vlerëson të menduarit e pavarur dhe kreativ të nxënësit.

Vërejtjet e mësues-it/es

Provim me shkrim
(gjysmëvjetori i parë)
Lënda: Letërsi

Emri dhe mbiemri i nxënësit _____

Lexoni tekstin e mëposhtëm dhe përgjigjuni pyetjeve:

“Një grimë mbeta si i mpirë, por lliri ma rrëmbeu gazetën nga duart.

- Ç’më rri ashtu?- tha ai gjithë inat. – Nuk gëzon që të ka dalë emri dhe vjersha është botuar?

- I çova sytë papë te strofa e botuar dhe te emri i shtypur me shkronja të zeza, për besë

Foqion Postoli, Eskili, Aleksandër Dyma (I biri) dhe në çast e harrova tekstin e përgjigjes dhe të dy, me llirin, nisëm të hidheshim përpjetë nga gëzimi.

Në drekë babai hyri në shtëpi i vrenjtur. Pa thënë asgjë m’u afrua, më zuri nga veshi dhe ma tërhoqi një copë herë.- “Ti, more mistrec, ke guxuar të vesh emrin tim në ato shkarravinat e tua, hë? More karagjoz, që kemi jetuar gjithë jetën me nder dhe erdhe ti të na turpërosh dhe ku pa, në gazete... Bëre, ç’bëre, të mos të shoh më të merresh me turpëri të tilla, more vesh?”

1. Si titullohet kjo pjesë dhe kush e ka shkruar _____

2. Ky tekst është:

- a. përrallë b. prozë poetike c. tregim d. legjendë

(rrumbullakosni alternativën e saktë)

3. Cili është personazhi grua që shfaqet në tekstin e plotë _____

4. Shkruani temën e pjesës _____

5. Për çfarë bëhet fjalë në këtë vjershë:

Porsi kanga e zogut t’verës

Që vallzon n’blerim të prillit

Porsi ambli fllad i erës

Që lëmon gjinjtë e trëndafilnit

Porsi vala e bregut të detit

Porsi gjama e rrfesë zhgjetare

a. për bukuritë e natyrës b. për stuhinë në det

c. për gjuhën shqipe d. për fatin e fëmijës

(rrumbullakosni alternativën e saktë)

6. Shkruani dy vargjet që vijnë më pas _____

7. Shkruani krahasimet dhe epitetet që gjenden në këtë pjesë

krahasime	epitete

8. Çfarë teme trajton poezia, nga janë shkëputur këto strofa:

O moj shqiptarkë
Që vete nget qetë
Edhe drekë e darkë
Kthehesh e bën vetë.

Moj e mjera grua
Ç'e do burrërinë
Të ftohet në krua
Dhe ti mban shtëpinë?

- a. dembelizmin e gruas b. sjelljen e saj të ashpër me burrin
c. dembelizmin e burrit d. sëmundjen e burrit

(rrumbullakosni alternativën e saktë)

9. Nga sa vargje janë të përbëra strofat _____ dhe a janë të ndërtuara me a. rimë apo b. pa rimë (nënvizoni përgjigjen e saktë)

10. Cila prej këtyre poezive është poezi peizazhi:

- a. Gjyshes b. Rrini këtu...! c. Kroi i fshatit tonë d. Gjuha shqipe

11. Vepra "Borgjezi fisnik" është:

- a. roman b. dramë c. poezi d. komedi e. tragjedi

12. Përshkruani me pak fjalë portretin e zotit Zhurden _____

Vlerësimi:

Kapitulli IV

Fatos Arapi

BREDHI I VITIT TË RI

Planifikim mësimi

Lënda: Letërsi

Klasa: VI

Tema mësimore: Fatos Arapi "Bredhi i Vitit të Ri"

Lloji: Poezi

Rezultatet e të nxëniet të kompetencave sipas temës mësimore. Nxënësi/ja:

- gjen temën dhe motivet e tekstit;
- interpreton tekstin, duke respektuar pauzat dhe theksat logjikë;
- evidenton figurat letrare dhe funksionin e tyre në tekst;
- ngjall përjetime emocionale të veçanta;
- arrin të shkruajë një poezi me të njëjtin temë.

Metoda e veprimtarisë me nxënësit: leximi emocional dhe recitimi i poezisë, nxitja e shpirtit kreativ dhe e të shprehurit bukur.

Organizimi i orës së mësimi

Veprimtaria e mësues-it/es:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Etapë e parë:

Mësues-i/ja pyet nxënësin se çfarë u sjell ndërmend pema e bredhit? A e vendosin bredhin për çdo Vit të Ri? Çfarë atmosferë krijon vendosja e bredhit në shtëpi? Kush e zbukuron bredhin në shtëpinë tuaj? Mësues-i/ja kërkon nga një nxënës që të vizatojë bredhin e Vitit të Ri në tabelë. Mësues-i/ja pyet nxënësit nëse dinë ndonjë këngë apo poezi që i kushtohet bredhit të Vitit të Ri.

Etapë e dytë:

Mësues-i/ja shkruan në tabelë titullin e poezisë "Bredhi i Vitit të Ri" dhe emrin e autorit Fatos Arapi. Bën një përshkrim të shkurtër të jetës dhe krijimtarisë së Fatos Arapit.

- Mësues-i/ja lexon në mënyrë interpretative tekstin, duke u ndalur te shenjat që sugjerojnë tekstin, si pauza, fundi i vargjeve, fjalët kyçe etj.
- Mësues-i/ja u shpjegon nxënësve motivet dhe domethëniet e kësaj poezie. Pastaj u bën pyetje nxënësve, në lidhje me mënyrën se si është kuptuar teksti:
 1. Pse qëndron në këndin e dhomës bredhi i vjetër?
 2. Larg kujt është ai?
 3. Pse ndahen përgjithnjë dy vite?
 4. Çfarë festojnë babë e bir?
 5. Si e përshkruan subjekti lirik atmosferën që krijon bredhi në shtëpi?

Mësues-i/ja udhëzon dy nxënës që ta recitojnë bukur poezinë.

Mësues-i/ja nxit përjetimet dhe interpretimin individual, i cili mbështetet në kapacitetet dhe kulturat e leximit të secilit nxënës.

Mësuesi u kërkon nxënësve të nënvizojnë fjalët me kuptim të figurshëm. Pastaj bashkëpunon me nxënësit për të shpjeguar cilat janë ato dhe çfarë funksioni kanë në këtë poezi.

Mësues-i/ja u kërkon nxënësve që të flasin për temën e poezisë.

Mësues-i/ja nxit nxënësit të diskutojnë me njëri-tjetrin për vlerat artistike të kësaj poezie.

Mësues-i/ja sugjeron ndarjen e vargjeve sipas motiveve që sugjeron poezia.

Mësues-i/ja udhëzon nxënësit që të gjejnë rimat që janë përdorur në tekst.

Detyrë:

Mësues-i/ja udhëzon nxënësit që të përpiqen e ta rishkruajnë në prozë këtë tekst poetik.

Kompetenca e vlerësimit:

Mësuesi duhet të dijë të vlerësojë nxënësit sipas veçantive të tyre asimiluese dhe krijuese

Vërejtjet e mësues-it/es

Viron Kona

BUBULINOJA ËSHTË KURESHTAR APO LLFAZAN

Planifikim mësimi

Lënda: Letërsi

Klasa: VI

Tema mësimore: Viron Kona "Bubulinoja është kureshtar apo llafazan"

Lloji: tregim (humoristik)

Rezultatet e të nxënësve sipas temës mësimore. Nxënësi/ja:

- arrin të dallojë karakteristikat e tregimit humoristik;
- lexon si duhet një tregim me humor e lojëra fjalësh;
- ritregon bukur përmbajtjen e këtij teksti;
- evidenton temën dhe motivet e tregimit.

Metoda e veprimtarisë me nxënësit: nxitja e të lexuarit me shprehësi, nxitja e diskutimeve në grup.

Organizimi i orës së mësimi

Veprimtaria e mësues-it/es:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Etapa e parë:

Mësues-i/ja pyet nxënësit se çfarë dinë për tregimet humoristike? Ajo improvizon një situatë ku fjalët dhe shprehjet keqinterpretohen dhe evidenton reagimin e nxënësve. Pastaj u kërkon nxënësve që edhe ata të krijojnë një situatë të tillë dhe t'ia lexojnë shokut. Mësues-i/ja pyet nxënësit se çfarë e shkakton humorin? Pastaj shpjegon funksionin që ka **loja me kuptimin e fjalëve në krijimin e një situatë humori** dhe emrin e figurës që e shkakton. Mësues-i/ja nënvizon rolin e kalambureve në krijimin e situatave humoristike.

Etapa e dytë:

- Mësues-i/ja shkruan në tabelë titullin e tregimit "Bubulinoja kureshtar apo llafazan" dhe emrin e autorit, duke bërë një përshkrim të shkurtër të jetës dhe krijimtarisë së Viron Kones, autorit të tregimit
- Mësues-i/ja zgjedh një nxënës dhe bashkë me të lexon në mënyrë interpretative tekstin, duke e vënë theksin te fjalët dhe shprehjet që keqkuptohen dhe shkaktojnë humor.
- Mësues-i/ja sugjeron dy nxënës të tjerë që ta lexojnë në të njëjtën mënyrë tekstin.
- Mësues-i/ja kërkon nga nxënësit që ta ritregojnë pjesën, duke shpjeguar keqkuptimet dhe të tregojnë se çfarë ndodh me tekstin. Po me dëgjuesin?
- Mësues-i/ja u kërkon nxënësve që të flasin për temën e tregimit.
- Mësues-i/ja u kërkon nxënësve të nënvizojnë shprehjet (frazologjike) nga të cilat vjen ky keqkuptim. Pastaj shpjegon domethëniet e tyre.
- Mësues-i/ja udhëzon nxënësit në zbërthimin e pyetjeve 6,7,8,9,11,12 që ka libri i nxënësit.
- Mësues-i/ja krijon grupe dyshe që ta interpretojnë në klasë tekstin. Pastaj së bashku me pjesën tjetër të klasës, pastaj, duke argumentuar, vlerëson grupin që ka interpretuar më mirë dhe i ka dhënë natyrën e komedisë këtij teksti.

Detyrë

Mësues-i/ja udhëzon që ta paraqesin me anë të Stripit fabulën e këtij teksti. Dhe u kujton nxënësve se stripi më i realizuar do të ekspozohet në ekspozitën e shkollës.

Kompetenca e vlerësimit:

Mësuesi duhet të dijë të vlerësojë nxënësit sipas veçantive të tyre.

Vërejtjet e mësues-it/es punës në grup.

Radovan Zogoviq

ALI BINAKU

Planifikim mësimi

Lënda: Letërsi

Klasa: VI

Tema mësimore: Radovan Zogoviq "Ali Binaku"

Lloji: poezi

Rezultatet e të nxëniet të kompetencave sipas temës mësimore. Nxënësi/ja:

- lexon tekstin, duke respektuar pauzat dhe theksat logjike;
- ndan tekstin në pjesë (strofa) dhe të përcaktojë motivin në secilën pjesë (strofë);
- gjen mesazhet që përçon ky tekst;
- identifikon figurat letrare.

Zhvillimi i kompetencave: të leximit dhe të kuptuarit

Metoda e veprimtarisë me nxënësit: leximi emocional dhe recitimi i poezisë, nxitja e të menduarit individual dhe e diskutimeve në grup.

Organizimi i orës së mësimi

Veprimtaria e mësues-it/es:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Etapa e parë:

Mësues-i/ja pyet nxënësit se çfarë dinë ata për historinë e vendit të tyre? A kanë dëgjuar ndonjëherë të flitet për Ali Binakun (apo Binak Alinë)? Në ç'formë e kanë dëgjuar: në formën e këngës apo të tregimit popullor? Si përshkruhet figura e tij në formën që ata kanë dëgjuar? Pse ai është figurë e dashur për popullin? Çfarë domethënie ka figura e tij?

Etapa e dytë:

- Mësues-i/ja shkruan në tabelë titullin e poezisë "Ali Binaku" dhe emrin e autorit Radovan Zogoviq, duke bërë një përshkrim të shkurtër të jetës dhe krijimtarisë së autorit.
- Mësues-i/ja lexon tekstin ngadalë, duke e vënë theksin te fjalët a shprehjet kyçe, që mbartin peshën kuptimore të poezisë.
- Mësues-i/ja shpjegon përmbledhtazi kontekstin historik, të cilit i referohet përmbajtja e poezisë.
- Mësues-i/ja tregon përmbledhtazi idetë dhe motivet e kësaj poezie. Shkruan në tabelë disa prej këtyre ideve dhe motiveve.
- Mësues-i/ja orienton nxënësit në një lexim të drejtuar, duke sugjeruar ndaljen në shprehjet që mbartin peshën kuptimore dhe emocionale të tekstit.
- Mësues-i/ja udhëzon nxënësit në ndarjen e poezisë në tri pjesë, sipas motiveve, dhe vendosjen e një titulli përfaqësues, siç ato e mendojnë, për secilën pjesë.
- Mësues-i/ja u kërkon nxënësve të nënvizojnë fjalët e reja dhe fjalët me kuptim të figurshëm.
- Mësues-i/ja shpjegon praninë e figurave të shumta letrare dhe funksionin e tyre në këtë tekst:

- | | |
|-----------------|---|
| a) simboleve: | "gardhe", "livadhe", "qershitë", "dielli"; |
| b) metaforave: | "Era të mos shtrihet"; |
| c) krahasimeve: | "si drithin", "si rrushin", "si bora e parë"; |
| d) epiteteve: | "I gjelbër (ujë)", "I rrëzuar (drithë) etj |

Nxit nxënësit të gjejnë në tekst të tjera figura në bazë të shpjegimit dhe shembujve që dha mësuesja.

- Mësuesja nxit përjetimet dhe interpretimin individual, i cili mbështetet në kapacitetet dhe kulturat e leximit të secilit nxënës.

Mësues-i/ja u kërkon nxënësve që të lexojnë vargjet/strofën që u ka lënë më shumë mbresa.
Mësues-i/ja orienton ndarjen e vargjeve sipas motiveve që sugjeron poezia.
Mësues-i/ja udhëzon nxënësit në zbërthimin e pyetjeve 4,5, 6,7 që ka libri i nxënësit.
Mësues-i/ja u jep nxënësve detyrën që duhet ta realizojnë në shtëpi:

Detyrë

Bëni një detyrë ku të tregoni përjetimin që keni ndjerë, kur e keni lexuar këtë tekst. Renditni disa prej mesazheve që teksti përcjell tek ju.

Kompetenca e vlerësimit:

Mësuesi duhet të dijë të vlerësojë nxënësit sipas veçantive të tyre.

Vërejtjet e mësues-it/es

Fadil Kraja

GJAKU I ARBËRIT

Planifikim mësimi

Lënda: Letërsi

Klasa: VI

Tema mësimore: Fadil Kraja "Gjaku i Arbërit"

Lloji: dramë

Rezultatet e të nxëniet të kompetencave sipas temës mësimore. Nxënësi/ja:

- arrin të evidentojë karakteristikat e gjinisë së dramës;
- ritregon brendinë e pjesës, duke e ilustruar me shembuj nga teksti;
- nxjerr idetë dhe mesazhet e kësaj drame;
- lexon dhe interpreton tekstin me role
- evidenton personazhin dhe artificin kyç në këtë dramë

Metoda e veprimtarisë me nxënësit: leximi me role i pjesës dhe punë individuale e diskutim në grup.

Organizimi i orës së mësimi

Veprimtaria e mësues-it/es:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Etapa e parë:

Mësues-i/ja u tregon nxënësve rreth baladës së Kostandinit dhe Doruntinës. Pyet nxënësit nëse kanë dëgjuar për këtë baladë apo variante të saj.

Tregon fabulën e baladës dhe ndalet te elementi i besës. Mësues-i/ja pyet nxënësit nëse kanë dëgjuar për rolin që ka ky element te shqiptarët. Mësues-i/ja u kërkon nxënësve të shprehin nëse besa për shqiptarët është:



- | | |
|-----------------------------|----------------------------|
| 1. Virtyt | 4. Ves |
| 2. Kapricio | 5. cilësi e brendshme |
| 3. E vlerësuar nga të huajt | 6. e përçmuar nga të huajt |

dhe kërkon që nxënësit t'i argumentojnë përgjigjet.

Etapa e dytë:

- Mësues-i/ja shkruan në tabelë titullin e dramës "Gjaku i Arbërit" dhe emrin e autorit Fadil Kraja. Bën një përshkrim të shkurtër të jetës dhe krijimtarisë së autorit.
- Mësues-i/ja u shpjegon përmbledhtazi lidhjet që ka kjo dramë me Baladën e Konstandinit pastaj shpjegon veçantitë e dramës.
- Mësues-i/ja ritregon përmbajtjen e pjesës dhe ndalet te figura e Lokes (nënës) dhe e Palit. Shpjegon simboliken që kanë këto dy figura në dramë.
- Mësues-i/ja zgjedh tre nxënës që të lexojnë me role pjesën. Gjatë leximit të pjesës, mësuesja tërheq vëmendjen e klasës te fjalët dhe shprehjet e rëndësishme për domethënien e pjesës.
- Mësuesja u kërkon nxënësve të gjejnë, nëse ka ndonjë motiv tjetër përveç atij të besës dhe të argumentojnë përgjigjen.
- Mësues-i/ja u kërkon nxënësve të gjejnë pjesën ku Rina përshkruan udhëtimin e saj me të vëllanë dhe të nënvizojnë fjalët ku sugjerohet fakti se Pali ka vdekur dhe është "ngritur nga varri".
- Mësues-i/ja udhëzon nxënësit që të përshkruajnë sesi e përfytyrojnë udhëtimin e Rinës me Palin.

- Mësues-i/ja u tregon nxënësve se pjesa ka monologë dhe dialogë dhe shpjegon karakteristikat e secilit prej tyre.

Monologu
karakteristikat:

Dialogu
karakteristikat:

- U kërkon nxënësve të përqendrohen te ligjërimi i Lokes, në fillim të pjesës dhe të shpjegojnë nëse ai është monolog apo dialog.

Mësues-i/ja udhëzon nxënësit në përgjigjet ndaj pyetjeve që janë në librin e nxënësit:

- Pse nëna i kërkon vajzës të heshtë dhe s'i beson kur ajo i thotë se e solli Pali?

- Çfarë simbolizon figura e Plakut? Po fjalët e tij: "U ngrit nga varri/dheu s'e mbajti dhe u ngrit", çfarë domethënie kanë?

Mësues-i/ja u kërkon nxënësve të shprehen se cili personazh do të donin të ishin dhe pse?

Detyrë:

Mësues-i/ja udhëzon nxënësit të bëjnë një **detyrë projekt** që të ketë në qendër afërsitë e kësaj vepre me baladën e "Kostandinit dhe Doruntinës" apo të ndonjë legjende a gojëdhëne që qarkullon në zonën e tyre dhe ka për motiv Besën. (Mësuesja sugjeron: Kërkoni ndihmën e mësuesit ose të afërmeve tuaj në realizimin e këtij projekti.)

Kompetenca e vlerësimit:

Mësuesi duhet të dijë të vlerësojë nxënësit sipas veçantive të tyre asimiluese dhe krijuese.

Vërejtjet e mësues-it/es

Kapitulli V

Qerim Ujkani

VENDLINDJES

Planifikim mësimi

Lënda: Letërsi

Klasa: VI

Tema mësimore: Qerim Ujkani "Vendlindjes"

Lloji: poezi

Rezultatet e të nxënësve të kompetencave sipas temës mësimore. Nxënësi/ja:

- gjen motivet e poezisë dhe idetë që përçon;
- interpreton tekstin, duke respektuar pauzat dhe theksat logjike;
- evidenton figurat letrare dhe funksionin e tyre në tekst;
- ngjall përjetime emocionale të veçanta;
- arrin të shkruajë një poezi me të njëjtin temë

Metoda e veprimtarisë me nxënësit: leximi emocional dhe recitimi i poezisë, nxitja e shpirtit kreativ dhe e të shprehurit bukur.

Organizimi i orës së mësimi

Veprimtaria e mësues-it/es:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Etapa e parë:

Mësues-i/ja kërkon nga disa nxënës që ta përshkruajnë me pak fjalë dhe bukur vendlindjen e tyre. Mësues-i/ja shënon në tabelë disa prej përcaktimeve më të bukura të bëra nga nxënësit.



(në çdo cep të yllit shkruan përcaktimet më të bukura të bëra nga nxënësit)

Pastaj bën pyetjet:

- Pse vendlindja është e rëndësishme për njeriun?
- Çfarë mbart dhe me dashurinë e kujt lidhet ajo?
- Pse thuhet se njeriu ngado që të shkojë nuk e harron kurrë vendlindjen?

Mësues-i/ja pyet nxënësit nëse kanë shkruar ata apo shokët e tyre, ndonjëherë, poezi për vendlindjen? Çfarë u ka mbetur në mendje nga poezitë e shkruara apo të lexuara? Mësuesja e ndërton këtë etapë të orës së mësimi në formë diskutimi.

Etapa e dytë:

- Mësues-i/ja shkruan në tabelë titullin e poezisë "Vendlindja" dhe emrin e autorit Qerim Ujkani. Bën një përshkrim të shkurtër të jetës dhe krijimtarisë së Qerim Ujkanit.
- Mësues-i/ja lexon në mënyrë interpretative tekstin, duke u ndalur te shenjat që sugjerojnë tekstin, si pauza, fundi i vargjeve, fjalët kyçe etj.
- Mësues-i/ja u shpjegon nxënësve motivet dhe domethëniet e kësaj poezie. Pastaj u bën pyetje nxënësve, në lidhje me mënyrën se si është kuptuar teksti:
 1. Çfarë ka parë për së pari në vendlindje, subjekti lirik?
 2. Cilat janë mbresat e veçanta që ka përjetuar duke u rritur?
 3. Si e përshkruan subjekti lirik, në strofën e fundit atmosferën që krijon në vendlindje?
- Mësues-i/ja sugjeron dy nxënës që ta recitojnë bukur poezinë.

- Mësuesi u kërkon nxënësve të nënvizojnë fjalët me kuptim të figurshëm. Pastaj bashkëpunon me nxënësit për të shpjeguar cilat janë ato dhe çfarë funksioni kanë në këtë poezi.
- Mësues-i/ja udhëzon nxënësit që të listojnë figurat letrare që gjenden në tekst, sipas modelit të mëposhtëm:

krahasime	epitete	metafora
Si zog	pranvera laroshe	agimin në lindje
_____	_____	_____
_____	_____	_____

dhe të nënvizojnë shprehjet që e përshkruajnë më bukur vendlindjen.

- Mësues-i/ja u kërkon nxënësve që të flasin për temën e poezisë.
- Mësues-i/ja nxit nxënësit të diskutojnë me njëri – tjetrin për vlerat artistike të kësaj poezie.
- Mësues-i/ja sugjeron ndarjen e vargjeve sipas motiveve që sugjeron poezia.
- Mësues-i/ja udhëzon nxënësit që të gjejnë rimat që janë përdorur në tekst.
- Mësues-i/ja u shpjegon nxënësve llojin e rimës, duke e ilustruar me fjalët fundore të strofës së parë. Ajo vë pranë fjalët me rimë të njëjtë. Pastaj njërin çift e shënon me **a**, ndërsa tjetrin me **b**. *bukur/flutur* dhe *shikuar/zbardhuar*. *Ilustrimi në strofë:*

Në ty, o vendlindja ime e bukur, a
 Unë së pari diellin kam shikuar b
 Vëllanë si zog, motrën si flutur. a
 Agimin në lindje duke zbardhuar b

Mësues-i/ja udhëzon nxënësit në zbërthimin e pyetjeve 3,4,5 9,12 13 në librin e nxënësit. Mësuesja udhëzon nxënësit që të bëjnë në fletore ushtrimet 12 dhe 13 dhe i vlerëson ato.

Detyrë:

Mësues-i/ja udhëzon nxënësit që të përpiqen të shkruajnë sa më bukur një punim të shkurtër për vendlindjen, të cilin do ta lexojnë përpara shokëve dhe shoqeve.

Kompetenca e vlerësimit:

Mësuesi / ja në fund i vlerëson nxënësit për demonstrimin e rezultateve të arritura.

Vërejtjet e mësues-it/es

J. V. Gëte

LULJA E GJETUR

Planifikim mësimi

Lënda: Letërsi

Klasa: VI

Tema mësimore: J. V. Gëte "Lulja e gjetur"

Lloji: poezi

Rezultatet e të nxënësve të kompetencave sipas temës mësimore. Nxënësi/ja:

- gjen temën dhe motivet e tekstit;
- formulon mesazhin (mesazhet) që përçon poezi;
- përshkruan gjendjen emocionale të subjektit lirik;
- evidenton figurat letrare dhe tregon vlerat estetike që ka teksti;
- shkruan një poezi me të njëjtën temë.

Metoda e veprimtarisë me nxënësit: Stuhi mendimesh; bashkëbisedim; leximi shprehës, nxitja e shpirtit kreativ dhe e të shprehurit bukur.

Organizimi i orës së mësimi

Veprimtaria e mësues-it/es:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Etapa e parë:

Mësues-i/ja e prezanton temën e re nëpërmjet një liste pyetjesh. Ajo pyet nxënësit me radhë, nëse kanë lule në shtëpi? Ku i kanë marrë? A kujdesen vetë apo prindërit dhe më të rriturit për lulet? A kanë mbjellë ndonjëherë lule? Si ka shkuar procesi i tyre: kanë lulëzuar apo janë tharë? Çfarë ju ngjallin ambientet me lule? A e kanë dëgjuar shprehjen se **kush kujdeset për lulet ka një shpirt artisti?** Si e kuptojnë këtë shprehje? Cilat lule do të donit të kishit në oborrin tuaj? Mësues-i/ja pyet nxënësit nëse dinë ndonjë këngë apo poezi që i kushtohet luleve? Mësuesja shkruan në tabelë titujt e poezive apo të këngëve që nxënësit prezantojnë.

Etapa e dytë:

Mësues-i/ja shkruan në tabelë titullin e poezisë "Lulja e gjetur" dhe emrin e autorit J. V. Gëte. Bën një përshkrim të shkurtër të jetës dhe krijimtarisë së Gëtes.

Mësues-i/ja shkruan në tabelë një listë me fjalë e shprehje të rëndësishme të tekstit:

Pyll; çudi m'u ba; lule të blerë; plot me erë; ta këput; të fishkem; shkyen; me rrënjë; kopsht; e mbolla; mbush me lule; plot me fletë.

- Mësues-i/ja shpjegon kuptimet e fjalëve të panjohura për nxënësin.
- Mësues-i/ja lexon vargun e parë pastaj drejton nxënësit të lexojnë me radhë dhe bukur vargjet.
- Mësues-i/ja u shpjegon nxënësve motivet dhe domethëniet e kësaj poezie.
- Mësues-i/ja sugjeron dy nxënës që ta recitojnë bukur poezinë.
- Mësues-i/ja nxit përjetimet dhe interpretimin individual, i cili mbështetet në kapacitetet dhe kulturat e leximit të secilit nxënës.
- Mësues-i/ja u kërkon nxënësve të nënvizojnë fjalët me kuptim të figurshëm. Pastaj bashkëpunon me nxënësit për të shpjeguar cilat janë ato dhe çfarë funksioni kanë në këtë poezi.
- Mësues-i/ja u kërkon nxënësve të shkruajnë për secilën strofë nga një fjali përmbledhëse që ka lidhje me foljet kyçe:

strofa	Foljet	Fjalitë përmbledhëse
I	hyra	
II	pashë	
III	këput	
IV	nxora	
V	mbolla	

Mësues-i/ja nxit nxënësit të diskutojnë me njëri tjetrin për domethëniet e strofave:

Ta këput kur desha
 Nga unë u kthye:
 “që un’ të fishkem
 Ti po më shkyen?”

Me rrënjë e nxora;
 E mora në gji;
 Në kopsht e çova
 drejt në shtëpi.

- A ka kuptim të personifikuar lulja? Kë personifikon ajo?
- Mësues-i/ja udhëzon nxënësit që të gjejnë rimat që janë përdorur në tekst.
- Mësues-i/ja orienton nxënësit në zbërthimin e pyetjes 2, për të gjetur numrin e strofave dhe vargjeve që ka poezia; të pyetjes 7, e cila kërkon që të përshkruhen emocionet që zgjojnë dy strofat e fundit; pyetjes 8 në lidhje me marrëdhënien në mes ritmit të poezisë dhe temës së saj.

Detyrë:

Mësues-i/ja u sugjeron nxënësve që të përpiqen të gjejnë në bibliotekën e shkollës, familjare, të zonës apo në internet poezinë “Vjollca” të Gëtes dhe të krahasojnë motivet me poezinë e temës së mësimit.

Kompetenca e vlerësimit:

Mësuesi duhet të dijë të vlerësojë nxënësit sipas veçantive të tyre asimiluese dhe krijuese.

Vërejtjet e mësues-it/es

Azis Nesin

NUK ËSHTË E LEHTË TA HARROSH

Planifikim mësimi

Lënda: Letërsi

Klasa: VI

Tema mësimore: Azis Nesin “Nuk është e lehtë ta thuash”

Lloji: tregim

Rezultatet e të nxënësve të kompetencave sipas temës mësimore. Nxënësi/ja:

- lexon rrjedhshëm dhe ritregon me pika, sipas rendit të ngjarjeve, fabulën;
- formulojnë idetë dhe mesazhet që përçon teksti;
- identifikon fjalët e personazheve nga ato të rrëfimitarit;
- gjen dhe argumenton teknikat që përdoren për të krijuar situatat e humorit

Metoda e veprimtarisë me nxënësit: Stuhi mendimesh; Diskutime në grup; nxitja e shkathtësisë së të lexuarit dhe e të menduarit kreativ.

Organizimi i orës së mësimi

Veprimtaria e mësues-it/es:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Etapa e parë:

Mësues-i/ja pyet nxënësit për përvojat që kanë pasur me mësuesit në vitet e mëparshme? U kërkon të shprehen se sa të vështirë e kanë pasur të përshtaten me metodat e ndryshme të mësuesve. Pyet, nëse kanë pasur ndonjë rast kur mësuesit e rinj kanë shprehur pakënaqësi për nivelin e njohurive që u është dhënë nga mësuesit pararendës? U kërkon që, nëse ka pasur, të tregojnë situata që janë krijuar.

Etapa e dytë:

- Mësues-i/ja pyet nxënësit nëse e kanë dëgjuar emrin e Azis Nesinit? Çfarë dinë për këtë shkrimtar dhe a kanë lexuar ndonjë tregim të tij?
- Mësues-i/ja shkruan në tabelë titullin e pjesës “Nuk është e lehtë ta harrosh” dhe emrin e autorit. Pastaj zgjeron njohuritë e nxënësve për këtë shkrimtar të shquar të letërsisë turke.
- Mësues-i/ja prezanton në mënyrë të përmbledhur përmbajtjen e pjesës dhe pastaj u kërkon nxënësve që ta lexojnë në heshtje atë dhe të nënvizojnë me **një vijë dialogun** ndërmjet mësuesit dhe fëmijëve dhe me **dy vija fjalitë** që përçojnë situatën e humorit.
- Mësues-i/ja shpjegon kuptimin e fjalëve dhe shprehjeve të reja.
- Mësues-i/ja u kërkon nxënësve të diskutojnë në lidhje me kërkesën që mësuesi u bën nxënësve: “Nxënës, ju duhet të harroni gjithçka që keni mësuar me mësuesen e mëparshme. Kuptuat? Çdo gjë do ta fillojmë nga e para”. Për ta ngacmuar diskutimin mësues-i/ja pyet:
 - A mendoni se mësuesi u shpreh drejt, kur u tha kështu fëmijëve apo ai duhet të kishte gjetur një mënyrë tjetër për t’u treguar nxënësve se si duhet të mësonin, pa i lënduar ato? Nëse mendoni se ka një mënyrë tjetër, cila do të ishte ajo mënyrë, sipas jush?
- Mësues-i/ja nxit një situatë për diskutim, duke pyetur nxënësit se si do të sillleshin ju në një rast të tillë? Pse nxënësi e kishte më të lehtë për të recituar vjershën “Delja”?
- Mësues-i/ja u kërkon nxënësve që të gjejnë në tekst pjesën, që i ka bërë për të qeshur dhe u shpjegon atyre elementet që e shkaktojnë atë.
- Mësues-i/ja u kërkon nxënësve të shpjegojnë marrëdhëniet në mes titullit të tregimit “Nuk është e lehtë ta harrosh” dhe përmbajtjes së tij.
- Mësues-i/ja diskuton me nxënësit përgjigjen që djali i jep mësuesit “Bëra çmos për të harruar ato që kisha mësuar më parë, por ishte e pamundur”. Mësues-i/ja u sugjeron ta argumentojnë mendimin, duke u mbështetur edhe në përvojat e tyre personale.

- Mësues-i/ja nxit nxënësit të diskutojnë në lidhje me mbylljen e tregimit, duke u sugjeruar që ta ndryshojnë atë.
- Nxënësit janë të lirë të bëjnë një mbyllje siç do të donin ata të ishte, duke argumentuar zgjedhjen.
- Mësues-i/ja orienton nxënësit në zbërthimin e pyetjeve 1,2,3, 6,7 nga libri i nxënësit.
- Mësues-i/ja orienton nxënësit të diskutojnë në lidhje me kuptimin e shprehjes "Shpesh një harresë të hapë shumë telashe". Dhe sugjeron bërjen e një eseje si detyre klase me këtë temë.

Detyrë:

Mësues-i/ja udhëzon nxënësit të gjejnë në tekst dhe të shkruajnë në fletore situatat që shkaktojnë humor. A kërkon që të japin mendimin e tyre se si shprehen këto situata humorit.

Kompetenca e vlerësimit:

Mësuesi / ja në fund i vlerëson nxënësit për demonstrimin e rezultateve të arritura.

Vërejtjet e mësues-it/es

Mitrush Kuteli

FUQIA E MUJIT

Planifikim mësimi

Lënda: Letërsi

Klasa: VI

Tema mësimore: Mitrush Kuteli "Fuqia e Mujit"

Lloji: tregim (përshtatje)

Rezultatet e të nxënësve të kompetencave sipas temës mësimore. Nxënësi/ja:

- kupton karakteristikat e teksteve të përshtatura;
- lexon rrjedhshëm dhe ritregon me pika, sipas rendit të ngjarjeve, fabulën;
- evidenton veprimet e Mujit nga ato të zanave dhe shokëve;
- shpjegon rolin e figurave letrare, sidomos hiperbolës në këtë tekst;
- formulon idetë dhe mesazhet e pjesës.

Metoda e veprimtarisë me nxënësit: nxitja e shkathtësisë së të lexuarit dhe e të menduarit, nxitja e diskutimeve në grup.

Organizimi i orës së mësimi

Veprimtaria e mësues-it/es:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Etapa e parë:

Mësues-i/ja pyet nxënësit nëse kanë dëgjuar për Ciklin e Kreshnikëve dhe për figurën e Mujit dhe Halilit? Ku? Për çfarë flitet në Ciklin e Kreshnikëve? Përse zakonisht në këto tekste personazhet marrin përmasa të jashtëzakonshme? Mësues-i/ja u kërkon nxënësve që ta hapin librin në temën e dytë, të kapitullit të dytë: çfarë u kujton tematika e stripit? Mësues-i/ja u prezanton nxënësve kopertinën e librit "Tregime të moçme shqiptare", në të cilët është portretizuar figura e Mujit. Mësues-i/ja pyet nxënësit nëse përputhet përfytyrimi i tyre me ilustrimin në kopertinë?

Etapa e dytë:

- Mësues-i/ja shkruan në tabelë titullin e pjesës "Fuqia e Mujit" dhe emrin e Mitrush Kutelit. Pastaj zgjeron njohuritë e nxënësve për këtë shkrimtar të shquar të letërsisë shqipe.
- Mësues-i/ja prezanton në mënyrë të përmbledhur përmbajtjen e pjesës dhe pastaj u kërkon nxënësve që ta lexojnë në heshtje atë dhe të nënvizojnë me **një vijë veprimet** e Mujit dhe me **dy vija dialogun** e tij me zanat.
- Mësues-i/ja shpjegon kuptimin e fjalëve dhe shprehjeve të reja.
- Mësues-i/ja u kërkon nxënësve të ritregojnë fabulën, duke u përqendruar në veprimet kryesore të historisë.
- Mësuesja orienton nxënësit në këtë proces, duke e nisur vetë zinxhirin e ritregimit të fabulës:

1. Muji punësohet bari lopësh;
2. Mujit i _____
3. _____
4. _____
5. _____
6. _____
7. _____

Mësuesi udhëzon nxënësit që në një tabelë të ndarë në dy pjesë të paraqesin elementet reale dhe fantastike të pjesës

Elementet reale (situata dhe personazhe)	Elementet fantastike (situata dhe personazhe)

- Mësues-i/ja u kërkon nxënësve që të shkruajnë listën e ofertave që zanat i bëjnë Mujit dhe zgjedhjen e tyre, duke e argumentuar.

Shpërblimet që ofrojnë zanat	zgjedhja e nxënësve	argumentet
a) forcë b) luftë c) mall d) dije		

- Mësues-i/ja udhëzon nxënësit që të portretizojnë figurën e Mujit para dhe pas fuqisë që merr nga zanat. Cila figurë letrare përdoret në portretizimin e dytë? Nxënësit shpjegojnë se çfarë është hiperbola dhe në fund krahasojnë shpjegimin e tyre me atë të shënuar te fjalori i nocioneve teoriko – letrare. Mësues-i/ja bën shpjegimin e kuptimit të fjalëve e shprehjeve të panjohura për nxënësit.

Detyrë – projekt:

Mësuesi udhëzon nxënësit që t’u kërkojnë prindërve që t’u tregojnë ndonjë ngjarje të ngjashme si ajo e Mujit dhe ta shkruajnë atë në fletore. Të bëjnë një tabelë ku në njërin anë të shkruajnë ngjarjet e besueshme të tregimit dhe në anën tjetër ato të pabesueshme, fantastike.

Kompetenca e vlerësimit:

Mësuesi / ja në fund i vlerëson nxënësit për demonstrimin e rezultateve të arritura.

Vërejtjet e Mësues-it/es

Kapitulli VI

Mark Gurakuqi

BUKË E KRYPË E ZEMËR

Planifikim mësimi

Lënda: Letërsi

Klasa: VI

Tema mësimore: Mark Gurakuqi "Bukë e krypë e zemër"

Lloji: tregim

Rezultatet e të nxëniet të kompetencave sipas temës mësimore. Nxënësi/ja:

- lexon rrjedhshëm dhe ritregon me pika, sipas rendit të ngjarjeve, fabulën;
- dallon karakteristikat e tregimi si lloj i tekstit letrar;
- formulon idetë dhe mesazhet që përçon teksti;
- identifikon fjalët e personazheve nga ato të rrëfimitarit;
- rendit motivet që përmban tregimi

Metoda e veprimtarisë me nxënësit: nxitja e shkathtësisë së të lexuarit dhe e të menduarit asociativ dhe kreativ, nxitja e diskutimeve në grup.

Organizimi i orës së mësimi

Veprimtaria e mësues-it/es:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Etapa e parë:

Mësues-i/ja nxit nxënësit për t'u përfshirë në diskutim, nëpërmjet një grupi pyetjesh: *çfarë dinë për motivin e mikpritjes? Pse konsiderohet si virtyt i rëndësishëm për shqiptarët? A e kanë dëgjuar shprehjen "bukë e krypë e zemër" dhe çfarë kuptimi ka për ta kjo shprehje?*

Mësues-i/ja nxit nxënësit të diskutojnë mbi kuptimin e kësaj shprehje.

Mësues-i/ja pyet nxënësit: *çfarë kanë mësuar në histori apo dëgjuar në rrëfime familjare ose tekste shkolle për figurën e Gjergj Kastriotit –Skënderbeut?*

Pse konsiderohet si figura më e rëndësishme për të gjithë shqiptarët? Me kë ka luftuar ai dhe kë ka mbrojtur?

Mësues-i/ja nxit nxënësit të rrëfejnë ndonjë legjendë apo gojëdhënë që ata dinë për Skënderbeun.

Etapa e dytë:

- Mësues-i/ja shkruan në tabelë titullin e pjesës "Bukë e krypë e zemër" dhe emrin e autorit Mark Gurakuqit, duke dhënë, në mënyrë të përmbledhur, të dhënat rreth jetës dhe krijimtarisë së autorit.

Tregon përmbajtjen, duke u përqendruar te pikat kryesore të ngjarjeve që rrëfohen në tregim.

- Mësues-i/ja shpjegon kuptimin e fjalëve dhe shprehjeve të panjohura për nxënësit.

Ndan tekstin në: pjesë ku rrëfen narratori; pjesë ku flet gruaja dhe pjesë ku flet Gjergji (Skënderbeu) dhe bashkë me dy nxënës lexojnë të ndarë në role pjesët. Udhëzon klasën që të nënvijëzojnë shprehjet:

1. ku tregohet zakoni i mikpritjes;
2. ku gruaja u shpreh mbështetjen Gjergjit dhe shokëve të tij (- Asht koha,- tha plaka dhe shtoi: - A sot, a kurrë);
3. ku Gjergji (Skënderbeu) mediton (mendon me vete) se ku qëndron fshehtësia e fitoreve mbi armikun;
4. ku përshkruhet mënyra se si Skënderbeu i prezantohet gruas.

- Mësues-i/ja nxit nxënësit të diskutojnë mbi secilën prej pjesëve që kanë nënvizuar.

- Mësues-i/ja ndan në dy grupe klasën dhe njërit grup i kërkon të përshkruajë portretin e plakës siç ata e përfytyrojnë nga cilësitë që jepen në tregim dhe grupi tjetër të përshkruajë portretin e Skënderbeut. Pastaj t'i lexojnë dhe të diskutojnë për realizimet e tyre.

- Mësues-i/ja udhëzon nxënësit të përshkruajnë skenën ku gruaja njih Skënderbeun dhe t'i vendosin një titull kësaj pjese, siç e mendojnë ata.

U shpjegon nxënësve motivet që përmban teksti.

- Mësues-i/ja kërkon nga nxënësit që të rendisin idetë dhe mesazhet që përçon tregimi.

- Mësues-i/ja udhëzon nxënësit në zbërthimin e ushtrimeve që janë në librin e nxënësit:
Pyetja 10, 11, 12. Ndhmon nxënësit për të kuptuar porosinë e plakës "Duhet me e zhbimë sa më parë këtë farë të keqe."

Pyetjet 18,19. Ndhmon nxënësit në ritregimin e pjesës, sipas pikave të planit. Dhe në gjetjen e figurave letrare që ka teksti.

Detyrë:

Mësuesja u lë për detyrë nxënësve të mësojnë përmendësh pjesën nga :

"Gjergji s'duroi ma e i tha _____ Biseduen deri vonë , aty rreth votrës",
deri në fund.

Projekt:

Udhëzon nxënësit ta dramatizojnë pjesën, duke ndarë rolet. Të përgatitin skenën, kostumet, dekorin dhe ta luajnë në teatrin e shkollës.

Kompetenca e vlerësimit: Mësues-i/ja vlerëson aftësinë e nxënësit për të lexuar bukur, për t'u shprehur e për të menduar në mënyrë kreative.

Vërejtjet e mësues-it/es

Zef Serembe

MIQËSIA

Planifikim mësimi

Lënda: Letërsi

Klasa: VI

Tema mësimore: Zef Serembe "Miqësia"

Lloji: poezi (sonet)

Rezultatet e të nxëniet të kompetencave sipas temës mësimore. Nxënësi/ja:

- lexon rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur poezinë;
- evidenton muzikalitetin (tingëllueshmërinë) e tekstit lirik;
- gjen motivet dhe mesazhet që përçon poezia;
- analizon figurat letrare që janë përdorur në poezi;
- u përgjigjet pyetjeve që lidhen me të kuptuarit e poezisë.

Metoda e veprimtarisë me nxënësit: Bashkëbisedim; nxitja e leximit shprehës dhe e të menduarit kreativ; nxitja e diskutimeve në grup.

Organizimi i orës së mësimi

Veprimtaria e mësues-it/es:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Etapë e parë:

Mësues-i/ja pyet nxënësit se çfarë domethënie ka fjala **miqësi** për to:



a) Ndjenjë dashamirësie, sakrifice e respekti të ndërsjellë dhe pa kushte

b) Përkrahje dhe mbështetje e njëri tjetrit, por me kushte.

Nxënësit zgjedhin alternativën dhe argumentojnë përgjigjen, duke e ilustruar me përvojat e tyre personale.

Mësues-i/ja pyet nxënësit a kanë lexuar ndonjë krijim (poezi, prozë, fabul, përrallë), ku të flitet për miqësi në mes të personazheve dhe u kërkon ta thonë. Po ashtu pyet nëse dinë ndonjë proverb popullor që flet për miqësinë (p.sh. *Një mik vlen më shumë sesa një thesar*).

Etapë e dytë:

Mësues-i/ja shkruan në tabelë titullin e poezisë (sonetit) "Miqësia" dhe emrin e autorit Zef Serembe, duke dhënë shkurtimisht të dhëna nga jeta dhe krijimtaria e autorit.

Mësues-i/ja u shpjegon nxënësve se kjo poezi është shkruar në **formën e sonetit** dhe shpjegon karakteristikat e tij.

Vargjet rimojnë me njëri tjetrin

Soneti

poezi lirike që ka një formë të jashtme të ngulitur.

përbëhet nga katër strofa, ku dy të parat janë ndërtuar me katër vargje, ndërsa dy të fundit me tri vargje.

- Mësues-i/ja u shpjegon nxënësve se për çfarë flet poezia. Ndan poezinë në motive, dhe thekson e shkruan në tabelë motivin kryesor. Pastaj udhëzon nxënësit ta plotësojnë me motivet e tjera.
 - Mësues-i/ja lexon me intonacionin e duhur, duke respektuar teknikat e leximit të poezisë, dhe u sugjeron nxënësve të nënvizojnë me një vijë fjalët dhe shprehjet e reja për ta dhe me dy vija figurat letrare.
- Shpjegon kuptimin e fjalëve të reja dhe funksionin e figurave letrare.
- Mësues-i/ja tregon funksionin simbolik të dallëndyshes dhe sugjeron domethëniet që përçon teksti nëpërmjet saj.
 - Mësuesja bën pyetje rreth të kuptuarit e pjesës nga nxënësit:
 - Për ku fluturon dallëndyshja? Ku kthehet ajo?
 - Kush ia preu rrugën dhe e mundi dallëndyshen?
 - Përse donte të kthehej dallëndyshja, kush e priste?
 - Çfarë i ndodhi në fund dallëndyshes?
 - Mësues-i / ja kërkon nga nxënësit të përshkruajnë emocionet që u ngjalli poezia (sidomos fundi i saj) dhe përfytyrimet që ju sjell ajo.
- Kërkon nga nxënësit ta lexojnë secilën strofë me kujdes dhe të gjejnë një titull përmbledhës për secilën.
- Mësues-i/ja udhëzon nxënësit në përgjigjet e ushtrimeve 3,4,5,6,8,9 të librit të nxënësit.

Detyrë:

Mësuesja udhëzon nxënësit të bëjnë një punim me temën "Miqësia", ku të shprehin në mënyrë artistike një ngjarje (të vërtetë apo të sajuar) që lidhet me këtë temë.

Kompetenca e vlerësimit:

Mësues-i/ja vlerëson aftësinë e nxënësit për të lexuar bukur, për t'u shprehur e për të menduar në mënyrë kreative.

Vërejtjet e mësues-it/es

Romen Rolan

KRISTOFI DHE PASANIKËT

Planifikim mësimi

Lënda: Letërsi

Klasa: VI

Tema mësimore: Romen Rolan "Kristofi dhe pasanikët"

Lloji: tregim

Rezultatet e të nxëniet të kompetencave sipas temës mësimore. Nxënësi/ja:

- është në gjendje të ritregojë fabulën;
- Të përcaktojë vendin dhe kohën e ngjarjeve;
- Të evidentojë karakteristikat e tregimit realist;
- Të identifikojë personazhet sipas veçorive të tyre;
- T'u përgjigjet pyetjeve që lidhen me të kuptuarit e tekstit narrativ.

Metoda e veprimtarisë me nxënësit: Stuhi mendimesh; nxitja e leximit të rrjedhshëm dhe e të menduarit kreativ, nxitja e diskutimeve në grup.

Organizimi i orës së mësimi

Veprimtaria e mësues-it/es:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Etapa e parë:

Mësues-i/ja nxit nxënësit të diskutojnë në lidhje me marrëdhënien e njeriut me pasurinë. Ai/ajo bën pyetjet:

A e përcakton vlerën e njeriut pasuria? A duhet të kemi turp nga statusi ekonomik që kemi? Si duhet të silllemi me njerëzit që kanë kushte më të këqija ekonomike se tonat? A është e hijshme t'i gjykojmë dhe t'i vëmë në lojë apo t'i pranojmë të tjerët nga pasuria që kanë? A është pasuria çelësi për lumturinë tonë?

Mësues-i/ja nxit nxënësit të tregojnë ndonjë ngjarje të lexuar apo reale (ku kanë qenë prezent) që kanë lidhje me këtë temë.

Mësues-i vlerëson me fjalë qëndrimin e nxënësve ndaj situatës.

Etapa e dytë:

- Mësues-i/ja shkruan në tabelë titullin e pjesës "Kristofi dhe pasanikët" dhe emrin e autorit Romen Rolan, duke dhënë përmbledhtazi të dhëna për jetën dhe krijimtarinë e këtij autori francez.

- Mësues-i/ja nxit nxënësit të shprehën se për çfarë mund të flasë një tregim me atë titull.

- Mësues-i/ja lexon tekstin pjesë - pjesë dhe u kërkon nxënësve të shënojnë pjesët që ndikojnë në rrjedhën dhe të kuptuarin e ngjarjeve. Pasi e mbaron leximin, mësues-i/ja u flet për përmbajtjen e këtij teksti, për mesazhet që ai përcjell.

U kërkon nxënësve që ta ndajnë tekstin në pjesë, sipas këtyre pikave:

1. Koha dhe vendi ku zhvillohen ngjarjet.

Nga "Ishte pasdite. _____
_____ deri te" _____ filloi të shikonte njerëzit tinëzisht _____"

2. Përshkrimi i situatës, kur Zonja e shtëpisë hyn në kuzhinë dhe merr me vete Kristofin.

Nga "Menjëherë të gjitha bisedat _____
_____ " deri te " posi delja kur e çojnë në thertore."

3. Takimi i Kristofit me fëmijët e zonjës.

Nga "Arritën në kopshtin ku dy fëmijët _____
_____ deri te " ishte i tronditur"

4. Veprimet e fëmijëve që fyejnë Kristofin.

Nga "Shih, shih, po këto janë teshat e mia _____"
"deri te "iu ulën mbi shpinë dhe ia përplasën fytyrën përtokë"

5. Reagimi i Kristofit.

Nga "Atëherë Kristofin e rrëmbeu tërbimi _____"
"deri te "përplasi djalin në mes të një hullie të ngushtë"

6. Reagimi i zonjës

Nga "Zonja vrapoi me aq shpejtësi _____"
deri te "Vetëm trupi i vocërrakut di të tregojë se si e rrahu"

- Mësues-i/ja udhëzon nxënësit të përshkruajnë portretin fizik dhe moral të dy fëmijëve të pasur.

Të përshkruajnë edhe se si e përfytyrojnë Kristofin në momentin e reagimit ndaj fëmijëve.

- Mësues-i/ja nxit nxënësit të diskutojnë se si do të kishin reaguar ata po të ishin në vend të Kristofit.

- Mësues-i/ja orienton nxënësit në zberthimin e pyetjeve 1,3,6,10, 14 në librin e nxënësit.

Kompetenca e vlerësimit:

Mësues-i/ja vlerëson aftësinë e nxënësit për të lexuar bukur, për t'u shprehur e për të menduar në mënyrë kreative.

Vërejtjet e mësues-it/es

Xhevahir Spahiu

DALLËNDYSHJA E FËMIJËRISË

Planifikim mësimi

Lënda: Letërsi

Klasa: VI

Tema mësimore: Xhevahir Spahiu “Dallëndyshja e fëmijërisë”

Lloji: poezi lirike

Rezultatet e të nxëniet të kompetencave sipas temës mësimore. Nxënësi/ja:

- arrin të identifikojë subjektin (heroin) lirik në tekst dhe të identifikohet me të;
- interpreton tekstin, duke respektuar pauzat dhe theksat logjikë;
- evidenton figurat letrare dhe funksionin e tyre në tekst;
- formulon motivet dhe idetë e poezisë.

Metoda e veprimtarisë me nxënësit: Diskutime; leximi emocional dhe recitimi i poezisë; nxitja e shpirtit kreativ dhe e të shprehurit bukur.

Organizimi i orës së mësimi

Veprimtaria e mësues-it/es:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Etapa e parë:

Mësues-i/ja pyet nxënësin se çfarë marrëdhëniesh kanë me zogjtë. A kanë parë ndonjëherë dallëndyshe? Çfarë karakteristikash kanë dallëndyshet? Pse fëmijëve u pëlqejnë dallëndyshet, çfarë sjellin ato kur vijnë? Po kur ikin? A ju kujtohet personazhi që kishte Serembe te poezia “Miqësia”? Çfarë përjetimesh ju solli dallëndyshja aty?

Mësues-i/ja shkruan në tabelë titullin e poezisë “Dallëndyshja e fëmijërisë” dhe emrin e autorit Xhevahir Spahiu. Bën një përshkrim të shkurtër të jetës dhe krijimtarisë së Xhevahir Spahiut. Mësues-i/ja lexon me shprehësi tekstin poetik, duke u ndalur te shenjat që sugjeron teksti, si pauza, fundi i vargjeve, fjalët kyçe etj.

Mësues-i/ja u shpjegon nxënësve motivet dhe domethëniet e kësaj poezie. Pastaj u bën pyetje nxënësve, në lidhje më mënyrën se si është kuptuar teksti:

1. Nga se i ngjallen kujtimet subjektit (heroit) lirik?
2. Ku dhe çfarë ka ndodhur?
3. Si e përshkruan ndodhinë dhe përjetimin subjekti lirik?
4. Çfarë bëri gjyshe Fatimeja?
5. Çfarë kuptimi ka shprehja në fund e gjyshe Fatimesë?

Mësues-i/ja u kërkon nxënësve të nënvizojnë fjalët me kuptim të figurshëm. Pastaj bashkëpunon me nxënësit për të shpjeguar cilat janë kuptimet e mundshme dhe çfarë funksioni kanë në këtë poezi.

Mësues-i/ja u kërkon nxënësve që të flasin për temën e poezisë.

Mësues-i/ja i udhëzon nxënësit që të krahasojnë figurën e dallëndyshit te Serembe dhe atë të Xh. Spahiut. U kërkon të ndërtojnë një tabelë për të pasqyruar veçantitë apo të përbashkëtat e tyre.

autorët	Të veçantat	Të përbashkëtat
dallëndyshja te Serembe		

Dallëndyshja te Xh. Spahiu		
----------------------------	--	--

Mësues-i/ja nxit nxënësit të diskutojnë me njëri – tjetrin për vlerat artistike dhe mesazhet që përçon kjo poezi.

Mësues-i/ja fton nxënësit të diskutojnë se si e kuptojnë vargun (shprehjen) “Lirinë e tjetrit mos e prek.”

Mësues-i/ja udhëzon nxënësit që të gjejnë rimat që janë përdorur në tekst dhe të shpjegojnë raportin në mes fjalëve të rimuara.

Mësues-i/ja udhëzon nxënësit në zbërthimin e pyetjes 1,2,3,6,7,8, 10,11.

Detyrë – projekt

Mësues-i/ja udhëzon nxënësit që të kërkojnë ndihmën e prindërve për të gjetur në bibliotekën e familjes apo në internet poezinë “Zogu dhe djali” të Naim Frashërit dhe pastaj të përpiqen të gjejnë të përbashkëtat dhe dallimet mes saj dhe poezisë “Dallëndyshja e fëmijërisë”.

Kompetenca e vlerësimit:

Mësuesi duhet të dijë të vlerësojë nxënësit sipas veçantive të tyre asimiluese dhe krijuese.

Vërejtjet e mësues-it/es

Provim me shkrim

(gjysmëvjetori i dytë)

Lënda: Letërsi

Emri dhe mbiemri i nxënësit _____

1. Lexoni tekstin e mëposhtëm dhe përgjigjuni pyetjeve:

“- Bubulino! Do ta qepësh, apo jo? - i bërtet babi i nervozuar.

Çfarë të qep, o ba, pantallonat që m’i grisi qeni kur më kafshoi?

- Mbylle të them! - ulëriti babi i Bubulinos.

- Derën të mbyll, o ba? -Ik, mbushu që këtu!

- Të mbush ujë? Do një gotë ujë ti babi?

- Ik, se më hëngre veshët!

- Kush t’i hëngri veshët? - e pyeti vogëlushi, duke parë gjithë kureshtje e keqardhje veshët e të atit.

Babi humbet durimin.

- S’ke faj ti që bën kështu, se s`të vret këpuca, je në rregull ti!

Fëmija hesht një çast, pastaj pyet me dhembje:

- Pse o ba, të ka vrarë këpuca ty? - dhe, duke thënë këto fjalë, ai sheh me keqardhje këmbët e të atit.”

2. Ky tekst është:

- a. komedi b. përrallë c. tregim d. legjendë

(rrumbullakosni alternativën e saktë)

3. Çfarë janë kalamburet _____

4. Shkruani temën dhe motivet e dramës “Gjaku i Arbrit”

5. Nënvizoni simbolet, krahasimet dhe epitetet që gjenden në këtë pjesë.

Livadhi pranveror është si uji i pastër i gjelbër;

- dielli të mos e turbullojë me gishtat e tij;

livadhi i lulëzuar në të bardhë është si bora e parë,

- zogu të mos lërë gjurmë nëpër të;

era të mos shtrihet mbi barin e vesuar, që të mos e përziejë

6. Çfarë i lidh poezitë “Miqësia” dhe “Dallëndyshja e fëmijërisë

- a. dashuria për detin b. simboli i dallëndyshes c) dashuria për nënën

7. Shkruani çfarë zgjedh Muji nga ato që i ofrojnë zanat:

- a. forcë b. fuqi c) mall d) dije

8. Shkruani një strofë apo një fragment të një prej pjesëve mësimore që ju ka pëlqyer më shumë. Thoni shkurtimisht arsyet.

9. Me sa vargje është ndërtuar strofa e mëposhtme. Çfarë rime ka ajo?

Matanë dritares dallëndyshet,
lodrojnë, cijatin pa pushim
Unë i shikoj dhe sjell ndër mend
një fshat të largët, një kujtim ...

Vlerësimi.

Shtojcë:

Leximet jashtë klase

Leximet jashtë klase janë një mënyrë e mirë për t'i orientuar nxënësit drejt librave të zgjedhur e të përshtatshëm për formimin e shijes estetike të ata, si edhe për t'u zgjeruar përvojat e dijet për botën, aftësinë e gjykimit e të sjelljes njerëzore.

Librat u hapin nxënësve dritaret e komunikimit me botën nëpërmjet modeleve, kohëve e përvojave të ndryshme dhe u kultivojnë dëshirën dhe dashurinë për librin në të ardhmen.

Në klasën VI nxënësit kanë gjashtë tituj për të lexuar. Në Ditarin e leximeve janë trajtuar secili prej tyre.

Synimet:

- të zhvillojë aftësinë e leximit dhe të përpunimit të shijes estetike;
- Të zhvillojë aftësinë e të menduarit krijues dhe analitik;
- Të zhvillojë aftësinë e të shprehurit të rrjedhshëm dhe me argumente;
- Të zhvillojë aftësinë e të analizuarit të kompozicionit, strukturës dhe mesazheve të veprës letrare.

I. Libri i parë:

"Barka me vela" i Hajro Ulqinakut

Hajro Ulqinaku është një autor i njohur i letërsisë për fëmijë, në Mal të Zi. Pjesa më e madhe e librave të tij e ka të pranishëm që në titull **detin** (si p.sh. "Fëmijët e detit", "Ligji i detit", "Panorama e detit", "Fëmijëria në bregdet", "Libri për detin" etj.) Ato trajtojnë ngjarje që lidhen me detin dhe detarët, e përdorin simbolikën e detit dhe personifikojnë detin.

E tillë është edhe përmbledhja me tregime "Barka me Vela".

Ky libër përmbledh nëntëmbëdhjetë tregime, të cilat janë përzgjedhur, si më të mirët, nga librat e tjerë.

Të gjitha tregimet i lidh dhe kompozon tema e detit, e marrëdhënies dhe e përjetimit mbi të.

Secili prej tregimeve të këtij libri mund të konsiderohet si një metaforë për detin, ndaj secili prej tregimeve të këtij libri grish fantazinë e fëmijëve për ta imagjinuar vetë botën e pafundme që ofron deti.

Në këtë libër fëmijët do të mësojnë më mirë se çfarë ka ndodhur gjatë kohërave, në detin e kaltër të Ulqinit; do të mësojnë rreth aventurave të piratëve që janë aq të dashura për ta, do të shfrenojnë fantazinë e tyre të tregimi për peshkun e artë, si edhe do të marrin informacione për mjetet lundruese, si barkat me vela, p.sh., të cilat, me siguri, i kanë parë gjatë pushimeve të tyre pranë brigjeve të detit të Ulqinit apo edhe diku tjetër.

II. Libri i dytë:

"Luli i vocërr" i Migjenit

Migjeni është një nga poetët dhe shkrimtarët më të rëndësishëm në letërsinë shqipe. Ai ka shkruar shume tregime, në të cilat flet për gjendjen e vështirë të fëmijëve, për pamundësinë e tyre ekonomike dhe sociale për të bërë një jetë normale. Krijime të tilla si "Zoti të dhashtë", "Zeneli", "Luli i vocërr", "Bukën tonë të përditshme falna sot" (por edhe në të tjera si: "Recitali i Malsorit", "Kanga e dhimbës krenare"), ilustrojnë më së miri këtë ide.

Në të tri tekstet e para ("Zoti të dhashtë", "Zeneli", "Luli i vocërr") personazhi bosht është një fëmijë, i cili jepet në luftë për mbijetesë, që përbuzet dhe injorohet nga shoqëria, sepse, padrejtësisht, nuk ka mundësi të jetë si ata.

Tema e padrejtësisë, e mjerimit, e falsitetit të moralit të shoqërisë, e revoltës së njeriut të nëpërkëmbur, janë temat kryesore që mbajnë të mbërthyer fantazinë e fëmijëve (por edhe të të rriturve).

Te tregimi "Luli i vocërr" na mbetet në kujtesë portretizimi i çizmeve të Lulit dhe kontrasti i fuqishëm ndërmjet tyre dhe këpucëve të fëmijëve të pasur. Ky kontrast sinjifikon në vetvete statusin social të të dy grupeve të fëmijëve. Fëmijëve do t'u mbesë në mendje edhe shprehja e famshme e autorit " se një ditë tollumbat e Lulit kanë me e hangër edhe mësuesin."

III. Libri i tretë:

"Zogu dhe Kulla" i Rrahman Dedajt

Rrahman Dedaj është një shkrimtar i njohur shqiptar, që ka jetuar dhe zhvilluar krijimtarinë e tij në Kosovë.

Libri "Zogu dhe kulla" është përmbledhje tregimesh i botuar shumë herë, shpesh edhe me titullin "Fshehtësia" apo "Tre diejt"

Tregimi "Zogu dhe kulla" nga i cili merr titullin edhe libri, është ndërtuar mbi dialogun imagjinativ dhe fantastik midis djalit dhe zogut. Tema është ajo e përrallave: transformimi i zogut në djalë dhe djalit në zog, transformimi i sjelljeve të tyre, i funksioneve, i habitateve të tyre. Por ky transformim rezulton i pamundur, sepse nëse ato do të ndryshonin identitetin e tyre, do të humbisnin gjithçka çfarë kishin pasur më të dashur e më të shtrenjtë.

Ky është një nga tregimet më të veçanta për fëmijët, sepse zgjon fantazinë dhe dëshirat e tyre për të provuar lirinë e pafundme që të jep imagjinata, dhe për të projektuar veten te dëshirat e djalit.

Te tregimi "Çupa dhe Hëna" jepet tema e dashurisë së pakushtëzuar së fëmijës për prindin. Në këtë tregim autori sugjeron se dashuria nuk është vetëm ndjenjë, por edhe përkushtim dhe përgjegjësi, sado i vogël që të jesh.

Tregimi "Tri vashat" është ndërtuar mbi bazën e motiveve dhe elementeve fantastike të përrallave, si edhe elemente nga kënga e Gjergj Elez Alisë.

Edhe tregimet e tjera të këtij libri kanë tema interesante dhe janë të realizuara mjaft bukur.

IV. Libri i katërt:

"Kozeta" i Viktor Hygoit

Viktor Hygo është një nga shkrimtarët e shquar të letërsisë franceze. Ai ka shkruar shumë romane, nga të cilët "Të mjerët" është ndër më të vlerësuarit. Në këtë libër ka një pjesë ku flet për një fëmijë, që rriten në kushte jashtëzakonisht të vështira, pa praninë e nënës dhe e keqtrajtuar nga njerëzit që u ishte besuar që ta rrisnin: zotit dhe zonjës Tenardie. Pikërisht nga ky libër është shkëputur dhe përshtatur për fëmijë libri "Kozeta."

Tema e kësaj vepra është historia e trishtë e mbijetesës së një fëmije të vogël e të pafajshëm, që lind nga një nënë, e cila detyrohet të shesë trupin e saj për të mbijetuar dhe që s'mund ta rrisë e t'i ndodhet pranë fëmijës së saj dhe që pas peripecive rritet dhe edukohet nga një njeri fisnik si Zhan Val Zhani.

Fati i Kozetës është i shënuar që të mos mbesë gjithmonë e keqtrajtuar dhe e nëpërkëmbur. Ajo mbështetet dhe edukohet me cilësi e virtyte nga një njeri i drejtë dhe human si Zhan Val Zhani.

Kozeta rrezaton mirësi dhe jo urrejtje, megjithëse jeta e ka vënë në sprovë të mëdha që në moshë të vogël.

Ndër personazhet e kësaj vepre, patjetër që nxënësit do të preferonin Kozetën, por edhe Zhan val Zhanin, si modelin e sjelljes njerëzore.

V. Libri i pestë:

“Dhëmbi i bardhë” i Xhek Londonit

Xhek London është një autor i njohur i letërsisë amerikane. Në veprat e tij ai trajton tema sociale që kanë të bëjnë me raportin e njeriut me njeriun; e njeriut me ambientin; e njeriu- tme kafshët; e njeriut me mbijetesën në kushte të vështira. Ai është një vëzhgues shumë i kujdesshëm i realitetit të qenieve të gjalla.

Edhe romani “Dhëmbi i Bardhë” trajton këto çështje. Por në këtë libër vëzhguesi është një kafshë, një qenie e hibridizuar në mes ujkut dhe qenit, një qen ujk.

Pjesa më e madhe e ngjarjeve jepet nga pikëvështrimi i personazhit kryesor, Dhëmbit të Bardhë (qenit ujk), me anë të të cilit autori kërkon të shqyrtojë sesi e shohin kafshët botën e tyre dhe atë njerëzve.

Ai sugjeron se si në sfidën për të jetuar, qenia (kafshë apo njeri) fuqizon intuitën për t’u përshtatur e për t’i sfiduar rreziqet.

Ky është një roman plot aventura dhe të papritura, ndaj ai e tërheq kureshtinë e nxënësit dhe e mëson atë për situatat e jetës.

Sigurisht, personazhi më i dashur është ai i Dhëmbit të bardhë, i cili në fund bëhet edhe heroi i ngjarjes.

VI. Libri i gjashtë:

“Robinson Kruzo” i Daniel Defosë

Robinson Kruzo është vepra e famshme e shkrimtarit anglez Daniel Defo.

Në këtë vepër rrëfëhet historia e një detari të ri, i cili në udhëtimet e tij aventurore drejt botës, humbet anijen dhe shokët (të cilët mbyten) dhe i duhet të jetojë për një kohë të gjatë, në një ishull të egër e të panjohur për të mbijetuar.

Çfarë i duhet të bëjë Robinsonit? Të rrijë e të presë vdekjen, apo të luftojë dhe të përsosë aftësisë e tij për të mbijetuar edhe në kushte të papërshtatshme?

Shpirti luftarak, natyra miqësore dhe besimi në forcat e veta e ndihmojnë Robinsonin që t’ia dalë të mbijetojë.

Një nga karakteristikat më interesante të këtij romani është fakti se ngjarjet jetojnë dhe rrëfëhen nga vetë personazhi kryesor. Ato rrëfëhen në veten e parë nga Robinsoni. Rrëfimi është aq i gjallë dhe dinamik sa na bën të përfshihemi emocionalisht në ngjarje. Ndaj i përjetojmë sikur po na ndodhin ne dhe bashkudhëtojmë me aventurat e tij.

Ky libër zgjon te nxënësit shpirtin e aventurës dhe modelin e dashurisë për punën dhe jetën.

